



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.06.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Vendimi nr. 307 datë 23.05.2018 për “Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të listës së Kandidatëve të Kualifikuar për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Rolant Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Pjerin Ndreu, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj Përparim Spahiu Edmond Haxhinasto Dhurata Çupi dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Evis Kushi, Agron Shehaj dhe Reme Lala.

Të ftuar:

1. Merita Zeqaj
2. Gentian Deva
3. Enkeleda Bega
4. Vilma Zhupaj
5. Lindita Skeja
6. Julian Zanaj
7. Rovenë Nuri Veizaj
8. Nevila Xoxa Resulaj

9. Miranda Shkurti
10. Rozeta Ivanova
11. Miklovana Ymerali Ago
12. Lulzim Mata

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Detyruar nga ligji “Për prokurimin publik”, veçanërisht neni 19/ 2: “Përbërja, zgjedhja dhe mandati i Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Ekonomisë zhvillon sot një seancë dëgjimore me gjysmën e parë të kandidatëve, përcjellë nga Këshilli i Ministrave, në bazë të ligjit, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Do të doja t’ju bëja me dije se kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimeve Publike emërohen nga Kuvendi, me propozim të Këshillit të Ministrave. Ky komision, dhe Kuvendi më pas, ka përzgjedhur kryetarin e Komisionit të Prokurimit Publik, ndërkohë që duhet të zgjedhë edhe katër anëtarë të tjerë, pikërisht për të qenë pjesë përbërëse me kohë të plotë e këtij komisioni.

Siç thuhet në pikën 3 të nenit 19/2 të ligjit “Për prokurimin publik”, Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton aplikimet e paraqitura dhe verifikon nëse kandidatët i plotësojnë kriteret për emërim, i dërgon Kuvendit listën e kandidatëve të kualifikuar sipas renditjes, si dhe listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë kriteret për emërim.

Gjatë përzgjedhjes së kryetarit ose anëtarëve të Komisionit të Prokurimeve Publike, Kuvendi nuk është i detyruar të ndjekë renditjen e paraqitura nga Këshilli i Ministrave. Nëse e vlerëson të nevojshme, Kuvendi ka të drejtë të ftojë për intervistë kandidatët që plotësojnë kriteret për emërim.

Pikërisht mbështetur në këto pika të nenit 19/2, këshilli i Ministrave ka dorëzuar pranë Kuvendit vendimin nr. 307, datë 23/5/ 2018, me anë të të cilit përcjell listën me 23 kandidatë të kualifikuar, bashkë me pikët referuese përkrah; së dyti, edhe listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për emërim.

Në zbatim të ligjit, sot janë ftuar trembëdhjetë kandidatë për t’u dëgjuar para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Listën e keni përpara. Do të fillojmë sipas renditjes, nga numri 1 deri te numri 12. Kandidatët janë paraqitur pranë Kuvendit, kështu që mund të fillojmë menjëherë me seancën dëgjimore.

Secili nga deputetët është i lutur që të adresojë pyetje për çdonjërin prej tyre, nëse ka interes. Nëse nuk ka, prezantimi i tyre do të quhet i mjaftueshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, urdhëroni!

Jorida Tabaku – Kryetar, ka pothuajse më shumë se një muaj që Partia Demokratike kërkon me insistim që maxhoranca dhe qeveria ta marrë seriozisht datën 26 dhe 28 qershor, kur vendoset për fatin e Shqipërisë për hapjen ose jo të negociatave. Janë pesë kritere, të cilat janë të palëkundura dhe nuk ndryshojnë. Janë pesë kritere, në lidhje me të cilat qeveria duhet të tregojë progres real, duke dëshmuar që e ka seriozisht procesin e integritetit. Janë pesë kritere, që duket se qeveria i ka braktisur totalisht. Ndër më të rëndësishmet, në të cilat një pjesë diskutohet sot këtu, por nga ana tjetër, Partia Demokratike ka një muaj që insiston, është pikërisht lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Sipas statistikave, minimalisht, një zyrtar në javë kallëzohet penalisht nga KLSH-ja për keqpërdorim fondesh. Nga buletinet dalin të dhëna të frikshme në lidhje me prokurimin publik. Unë dua të përmend faktin se në katër vite, 2014-2018, qeveria dhe maxhoranca kanë proceduar rreth 36 mijë tenderë, ndërkohë që me negocim pa shpallje janë dhënë pothuajse 10 mijë tenderë. Një ndër tre tenderë jepet pa garë. Në një ndër tre tenderë caktohet fituesi, ndërsa Komisioni i Prokurimit Publik rri e shikon. Një ndër tre tenderë, me vlerë pothuajse 250 milionë euro, jepet pa konkurruar, ndërsa Komisioni i Prokurimit Publik nuk merr asnjë masë.

Në qoftë se do të ishte zbatuar ligji “Për Prokurimin Publik”, për të cilin ne jemi mbledhur sot këtu, për ta zbatuar, dhe në qoftë se do të ishte caktuar oferta më e ulët fituese, a e dini se buxhetit të shtetit do t’i ishin kursyer pothuajse 60 milionë euro?

Në katër vjet qeveria shqiptare, institucionet shqiptare, maxhoranca dhe Komisioni i Prokurimit Publik kanë ndenjur duarkryq, duke caktuar tenderë pa garë, duke dhënë koncesione tek firma që kanë edhe ofertën më të lartë.

Vetëm për periudhën 2017-2018, në qoftë se ligji do të zbatohet, pothuajse 60 milionë euro do të kurseheshin. Dy teatro mund të ndërtoheshin.

Është shqetësues fakti që dje, institucionet e Bashkimit Europian, Komisionit Europian, publikuan të dhënat e shqiptarëve që kanë aplikuar për azil në vendet e Bashkimit Europian. Përveç 1 milion shqiptarëve për Green Card në lotarinë amerikane, pothuajse 157 mijë shqiptarë kanë aplikuar për azil në vendet e Bashkimit Europian. Një e dhënë e frikshme. Shqipëria zë vendin e katërt, pas vendeve të luftës.

Kjo ndodh si rezultat i krimit dhe i korrupsionit në Shqipëri. Kjo ndodh për shkak se sot punësohen militantët e partisë dhe jo të rinj që janë të detyruar të largohen nga vendi. Kjo ndodh sepse sot, në radhët e policisë janë punësuar persona që kanë lidhje me krimin e organizuar, dhe të rinjtë nuk u qasen dot institucioneve shtetërore dhe institucioneve publike.

Një pjesë tjetër e madhe e shpenzimeve, sigurisht e tepsisë së qeverisë, shkon edhe për partneritetin publik privat. Çfarë ka bërë Komisioni i Prokurimit Publik për aferën e inceneratorëve, që Partia Demokratike ka denoncuar, të paktën që prej një viti: 178 milionë euro inceneratorët, të cilët i janë dhënë pa garë një fituesi të vetëm, kompani-fantazmë, me fonde offshore. Çfarë ka bërë Komisioni i Prokurimit Publik dhe institucionet shqiptare?

Në raportin e progresit thuhet e zezë mbi të bardhë: “Inceneratorët, përveçse vepër korruptive janë njëkohësisht edhe kundër parimeve që Bashkimi European ka.”

Çfarë ka bërë qeveria shqiptare? Asgjë.

Pesë kuksiane janë ende sot në burg, sot që diskutohet për tarifën e re të rrugës së kombit, e ndërkohë që vazhdon të diskriminohet një zonë e tërë në Veriun e Shqipërisë, ministri i Brendshëm rri i qetë në zyrën e tij. Ndërkohë, vëllai i tij trafikant, vetëm para dy javësh shkoi e u dorëzua, me vullnet të lirë thoni ju, por si një turist themi ne, tek institucionet italiane.

Një zonë e tërë në Veri të Shqipërisë po vuan sot për bukën e gojës, 14 % ishte rënia ekonomike në zonën e Kukësit, sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, sepse ata njerëz nuk shohin të ardhme, ndërkohë që do të detyrohet të paguajnë përsëri i gjithë Veriu i Shqipërisë një taksë për të cilën nuk është diskutuar kurrë dhe nuk është folur kurrë.

Shqiptarët presin në fund të qershorit vendimin për hapjen e negociatave. Po si mund të hapen negociatat, kur të gjitha këto afera korruptive, që ne përmendëm sot këtu, por që i përmendim përditë, duke filluar me inceneratorët, duke vazhduar me teatrin, duke vazhduar me aeroportin e Vlorës, me AIR Albania, është e pamundur t’i çosh në Gjykatë Kushtetuese, nga që Shqipëria nuk ka sot një Gjykatë Kushtetuese.

Sot Shqipëria është ndër vendet e vetme në botë, ku çdo gjë vendoset, firmoset, vuloset, gjykohet e vlerësohet po nga vetë qeveria, ku të gjitha procedurat i zhvillon vetë qeveria, ku askush nuk ka mundësi as të ankimojë një ligj të vetëm.

Shqipëria është vendi i vetëm në botë, ku ligjet vinë të përgatitura me emra biznesesh, ku vinë vendime qeverie të përgatitura me emra biznesesh, por që askush nuk ka mundësi t’i çojë këto në Gjykatë Kushtetuese, sepse e ashtuquajtura reformë në drejtësi e ka lënë vendin pa

gjykata, e ka lënë vendin pa Gjykatë Kushtetuese, e ka lënë vendin pa drejtësi, sepse sot të gjitha pushtetet i ka qeveria.

Ne kemi denoncuar këtu, në këtë komision, por edhe në podiume të tjera, faktin se ekonomia është duke u kriminalizuar. Kemi diskutuar shqetësimin në lidhje me rënien e euros. Në fakt, Banka e Shqipërisë mori një masë javën e kaluar, për të cilën, po të na kishin dëgjuar, do të kishim sugjeruar se nuk varet nga politikë monetare ose çdo lloj politike tjetër që mund të marrë Banka e Shqipërisë, sepse kriminalizimi i ekonomisë ka ardhur si rezultat i vullnetit politik të qeverisë.

Nëse duhet të pastrohet ekonomia, nëse duhet të rritet vlera e eksporteve, që të rritet vlera e produkteve shqiptare, nëse duhet që sot shqiptarët të kenë më shumë të ardhura në llogaritë e tyre, që të ardhurat që vijnë nga remitancat, nga fëmijët e shqiptarëve, të cilët punojnë në Europë, të kenë më shumë vlerë, duhet ndërruar qeveria, sepse prandaj ka ardhur kriminalizimi i ekonomisë, prandaj ka rënë vlera e euros. Nuk ka efekt asnjë lloj politike monetare, në qoftë nuk ndodh kjo.

Së fundi, edhe dy fjalë për atë që ka ndodhur dje në këshillin bashkiak të Hasit, me propozim të këshilltarëve socialistë: është nderuar zoti Gafur Mazreku, i vetmi deputet në historinë shqiptare, që ka gjuajtur me armë në një sallë parlamenti, një person që është dënuar nga gjykatat shqiptare. Në fakt, nuk është çudi që maxhoranca t'i vlerësojë e t'i nderojë ata që gjuajnë, ata që janë vrasës, ata që janë kriminelë. Deri dje i kishim në parlament, sot janë në strukturat e Partisë Socialiste në të gjithë Shqipërinë.

Nuk është absolutisht çudi për të gjithë shqiptarët, që ndodh kështu. Nuk është absolutisht çudi, që mbasi kjo ndodh, qeveria reagon e habitur, se përse ndodhi kjo dhe çfarë ka ndodhur. Në fakt, kjo më bën të kujtoj edhe një barsoletë të vjetër shkodrane, sipas së cilës Pal Vata thoshte: “Këtë e ka ba shoku Mehmet, se unë e Enveri nuk dimë gjë”. Shoku Enver, kësaj radhe, hiqet sikur nuk dinte gjë, por çdo gjë, që nga kriminalizimi i ekonomisë, droga dhe çdo vendim i vetëm merret nga i pari në Tiranë, ashtu siç thoshin edhe përgjimet e trafikantëve të drogës. Nuk ndodh asgjë në këtë vend pa dijeninë, pa mbështetjen dhe pa inkurajimin e Kryeministrit të vendit. Për këtë arsye, e përsëris edhe një herë kërkesën që i bëjmë prej një muaji qeverisë shqiptare: ta marrin seriozisht procesin e integritetit, të ulemi bashkë, t'i plotësojmë ato kritere dhe të fillojmë nga lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; ta marrin seriozisht dhe t'u ofrojmë një mundësi shqiptarëve, duke hequr ministrin e Brendshëm dhe duke i thënë stop të

gjithë kësaj që po ndodh me ekonominë, me të ardhmen e vendit, me të rinjtë shqiptarë që largohen përditë. Faleminderit!

Erion Braçe – Në fakt, doja t’ju kujtoja edhe një herë se jemi mbledhur në një seancë dëgjimore në lidhje me propozimin që ka ardhur mbi aplikimet për anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik. Natyrisht, kjo është një axhendë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, pastaj edhe axhendë e komisionit, ndaj ne do të vijojmë me këtë axhendë. Axhendat e partive politike, pa asnjë lloj diskutimi mund t’i ndjekë kushdo, si të dojë dhe ku të dojë. Komisioni ka detyrën e vet.

Në gjithë sa thatë, pas asnjë lloj diskutimi që jeni në të drejtën tuaj ta thoni, madje të thoni edhe më shumë se kaq, por pjesa dërrmuese e tyre jo vetëm që s’ka lidhje me axhendën e integritetit, por një pjesë e konsiderueshme e tyre janë edhe rrena. Nuk e di si thoshte Pal Vata, por vazhdojnë të quhen rrena.

Së pari e mbi të gjitha, Partia Socialiste s’ka propozuar kurrkënd për ta bërë qytetar nderi. As më pak e as më shumë, këshilltarët e Partisë Socialiste s’kanë propozuar kurrkënd për ta bërë qytetar nderi në Has, në Kukës apo në Tiranë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

As që më intereson fare.

Partia Socialiste ka vetëm një këshilltar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Partia Socialiste ka vetëm një këshilltar në këshillin bashkiak të Hasit, i cili ka votuar kundër. Sa për këtë kënaqësinë e këtyre që gjuajnë, po, zonjë kryetarin e partisë tënde e keni gjuetar të madh, ka vrarë 4 njerëz në mes të bulevardit bashkë me nënkryetarin e partisë tënde. Dakord? Dashuria e madhe për këta që gjuajnë fillon te partia një herë, pastaj shpërhapet lart e poshtë nëpër Shqipëri!

Zoti Spaho, doni të flisni? Po, urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Po, patjetër, nëse ke replikë...

Erion Braçe - Zoti Spaho nuk e doni fjalën? Replikë? Jo, nuk ka replikë, sepse jemi jashtë rendit të ditës.

Edmond Spaho - Zoti kryetar, nuk dua të bëj debat me ju, por meqenëse i cilësove gënjeshtër një pjesë të atyre dhe më specifikisht ju referuat propozimit për dhënien e titullit “

Qytetar nderi” figurës së madhe të trojeve të Veriut, po ju kujtoj se propozimi është me shkrim, nga një përfaqësues i Partisë Socialiste, kryetari i bashkisë së Hasit. Nëse mendon se nuk është juaji, sikurse ju sugjeruam dje, shkarkojeni! Por në kushtet që ai është kryetari juaj i bashkisë, duhet ta shkarkoni, sepse edhe ju vetë, së paku formalisht u shprehët: “Ngjarja është e turpshme!”, është e turpshme, është provokim i ulët, i ndyrë. Në një kohë që të majtë dhe të djathtë e kanë pranuar edhe figurën e atij, pa dashur të bëjmë politikë, edhe se pse është vrarë. Është një provokacion që bëhet në një periudhë jo të qetë politike. Nëse doni t’i hidhni benzinë zjarrit, është zgjedhja juaj, por këto lloj formash, kinezërira nuk janë të mira, “kinezërra”, siç thoshte ish- kryetari i partisë së tyre. Pra, është mirë që të mos vazhdohet në këtë pistë. Kur veproni gabim, së paku kini kurajën dhe merrni përsipër përgjegjësinë, por mos hajdeni këtu dhe të na thoni: “Gënjeni!”.

Për t’u kthyer tek tema, ky komision ka më shumë se 3 muaj që nuk funksionon, është pa njerëz, por edhe kur ka qenë me njerëz, nuk është se ka bërë ndonjë punë të madhe, jo se është i panevojshëm, por politikat që ndiqen janë të tilla që e kanë nxjerrë jashtë loje. Pse? Sepse, në radhë të parë fondet publike te ne përdoren për partneritet publik- privat, nuk ka nevojë për Komisionin e Prokurimeve Publike se vendimet i merr Kryeministri, ai i cakton se kush do të marrë fondet publike për t’i përdorur në partneritet publik -privat. Ai zgjedh kompanitë, ai përcakton vlerën e projektit, ai përcakton sesa do të zgjasë ndërtimi, sa do të fitojë njëra palë, sa do të fitojë pala tjetër, sa do të fitojë ai vetë. Duken si sajesa, por realiteti tregon se janë tërësisht të vërteta. Por edhe nëse nuk do të përdoren nëpërmjet partneritetit publik- privat, edhe për atë pjesë që zhvillohen tenderë publikë jepen me 99 pikë ca për qind e vlerës. Rrallë ndodhë që në ndonjë tender të merret nën 99 % të vlerës. Praktikisht komisionet e tenderimit, procedurat e ankimimit nuk kanë se çfarë punësh të bëjnë, sepse rezultati është i paracaktuar.

Do t’ju jap disa shembuj. Këtu pjesa dërrmuese përdoret me partneritet publik- privat, koncesionet që dha në shëndetësi, janë jo pak, por 400 milionë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka ndonjë gjë kolegu?

Pse këtu nuk jemi në parlament? Komisioni i kujt është, nuk është i parlamentit? Këto që po flas, a nuk janë për prokurimin publik?

Ilir, këtu jemi në parlament dhe unë po flas për prokurimin publik. Do të flas edhe për të tjera, pasi të mbarojmë me rendin e ditës.

Mos u mërzit! Shiko kryetarin sa i qetë është!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju po dëgjoni, por nuk reflektoni! Duhet të reflektoni!

Kryetar, mos e humb qetësinë, deri tani ke qenë mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sikurse e përmendi edhe kolegja ime parafolëse, për koncesionet e inceneratorëve, çfarë bëri Komisioni për Prokurimin Publik? Bëri ndonjë verifikim? Megjithëse janë publikuar me dhjetëra fakte për këtë aferë, ku ndahen paratë e buxhetit të shtetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di shumë mirë...

Ju kështu gjykoni, kur harxhohen 170 milionë euro të buxhetit, i jepen në avancë, paradhënie një kompanie...

Erion Braçe- Gënjen edhe për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho – Për inceneratorin e Fierit...

Erion Braçe – Nuk janë aq.

Edmond Spaho- Ai i Fierit, a i ka marrë në avancë?

Erion Braçe- Kërko interpelancë!

Edmond Spaho –Interpelancë po bëj dhe po kërkoj: këto institucionet e prokurimeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka njeri më të rëndësishëm këtu për të gjitha problemet e ekonomisë? Ky komision i trajton. Si përfaqësues i opozitës po të kërkoj llogari: pse i jepni paratë e buxhetit të shtetit paradhënie...

Erion Braçe – Nuk i kam dhënë askujt asnjë lek paradhënie.

Edmond Spaho – ...për të ndërtuar një incenerator, i cili edhe për kapacitetet që është projektuar është shumë më i madh se sa nevojat që ka vendi.

Erion Braçe - Thirr ministrin në interpelancë! Çfarë pune kam unë?

Edmond Spaho – Unë po të them ty si përfaqësues i maxhorancës.

Erion Braçe - Unë nuk kam lidhje fare. Ministrat firmosin në emrin e tyre, jo në emrin tim dhe as unë në emrin e tyre.

Edmond Spaho – Doni formë tjetër sesi abuzohet me pronën publike? Kryeministri mori tokën e stadiumit dhe po bën një kullë 25-katëshe, ku shlyen edhe paratë e drogës, sajdis edhe nomenklaturën që ka rrotull tij. Ju jeni dhe i sportit dhe i ndiqni, a keni parë ndonjë stadium me kullë?

Erion Braçe - Nuk kam lidhje me Federatën Shqiptare të Futbollit.

Edmond Spaho- Edhe “Partizani” stadiumin e ka pa kullë.

Erion Braçe - E dinë të gjithë që unë nuk kam lidhje me Federatën.

Këtu ka që bien në dashuri me Armando Dukën, mund të jenë këta të dy.

Më vjen keq!

Edmond Spaho – Kulla e stadiumit, Rruga e Arbrit...

Erion Braçe - Për Rrugën e Arbrit fol sa të duash, për Armandon...

Edmond Spaho - 200 milionë euro do të dorovitet klientela. Për statusin e minatorit, që thotë zoti Spahiu, e keni lënë për kalendat greke. Atyre njerëzve shumë pak para nga këto do t’u mjaftonin për t’ua plotësuar statusin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe - Kam folur edhe për minierat, por nuk ishte ti atëherë. Merreshe me punë të tjera.

Edmond Spaho - Do rast tjetër të abuzimit me fondet publike?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe - Unë vazhdoj të kem të njëjtin qëndrim për minierat. Ti e ke ndryshuar. Vazhdo! Unë do të vazhdoj të jem kundër minierave, ti vazhdo merru me minierat!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përparim, nuk merrem me këtë punë. Ti je shumë afër televizioneve. Unë merrem me sport.

Edmond Spaho – Kryetar, a të vazhdoj unë?

Erion Braçe - Të mbarojë zoti Spaho! Mos i ndërhy zotit Spaho!

Edmond Spaho - Të marrim aferën tjetër, tek Teatri, a është abuzim me fondet publike? Po merrni tokën në qendër të Tiranës, po ia jepni një privati, kur është tokë shtetërore, po ia jepni një privati që të ndërtojë kulla, një kompleks kullash me justifikimi se gjoja ai do të

ndërtojnë teatrin. Teatri ndërtohet kollaj: shite atë tokën, me çmimin që ka në qendër të qytetit që është edhe më e lartë sesa në New York dhe me një pjesë të atyre parave mund të ndërtohet një teatër i ri, nëse do ta ndërtosh, pa e prishur këtë.

Doni rast tjetër sesi abuzohet me pronën shtetërore dhe me paratë e buxhetit? Linja ajrore *Air Albania*, me çfarë transparence po krijohet kjo kompani? Pse nuk u bë me tender publik, ku të ftohej një kompani, meqenëse keni kaq shumë dëshirë për ta ngritur atë, mirë bëni, pse të mos ketë edhe një linjë shqiptare? Pse të mos bëhet me tender të hapur? Kur të vijë kompanitë e huaja të japin ofertat e tyre, por duhet të krijojmë një kompani të përbashkët me një individ, i cili si aktivitet biznesi, ka shërbimin e varrimit, *exchange*-in, është pronar i një ekipi futbollit me një kapital prej 100 mijë eurosh. Ku është transparencë? Kush e shqyrtoi ofertën e tij? Kush e mori vendimin? Edi Rama, se e ka mikun e tij, që nuk dihet se ku e ka bazën, ku i ka rrënjët, me çfarë merret, por duhet ta pranojmë si investitor të madh dhe serioz, sepse thotë Edi Rama! Edhe sikur të jetë i tillë, ka rregulla dhe procedura, duhet t'u nënshtrohet të gjitha ligjeve, rregullave dhe procedurave mbi të cilat zhvillohet biznes, jepen pasuritë shtetërore, jepen fondet publike. Kur qenka kështu, pse të mos e marrë njëri nga ne 51% të pronësisë së kompanisë ajrore, po u dashka ta marrë Sinani? Ku është sakrifica që po bën Sinani në emër të atdheut, që ka ardhur nga humbëtitat e Anadollit këtu, sepse i qan zemra për popullin shqiptar?!

Doni një shembull tjetër, aeroporti i Vlorës, që është shpërdorim i pronës publike. Jepni tokën, jepni edhe biznesin, merrni gjysmën e biznesit që ka Aeroporti i Tiranës dhe ia kaloni atij.

E dyta, i jepni garanci shtetërore, garanci nga buxheti, që nëse nuk t'i realizohet numri i fluturimeve, i pasagjerëve, do t'ia mbështesni me buxhetin e shtetit. Prapë, Sinani është aty.

Kjo është transparencë? Ky është miradministrimi? Komisioni i Prokurimeve Publike pikërisht këtë ka objektiv të punës së tij, miradministrimin, ndjekjen e rregullave, ndjekjen e ligjeve. Por kur Kryeministri, që është i pari i këtij katundi nuk respekton asnjë rregull, asnjë ligj, po gjithçka ua shpërndan miqve dhe shokëve të tij, atëherë çfarë duhet të bëjmë ne si opozitë? Të rrimë të bëjmë sehir?

Këto janë, midis shumë të tjerave, arsyet që Komisioni European, shtetet e BE-së më saktë (se po të jetë për Komisionin European, ai është me duar me e këmbë gati), refuzojnë të hapin negociatat me Shqipërinë.

Erion Braçe – Komisioni është armiku ...(qesh)

Edmond Spaho – Qesh ti, qesh, por për një javë do të kesh vendimin, atëherë do të shohim se kush do të qeshë, por do të jetë e qeshur dhe e qarë bashkë ...

Erion Braçe – Po çfarë thua? Si mundet t'i shpallësh luftë edhe komisionit tani? Merru me ne, ç'ke me komisionin?

Edmond Spaho – Para 10 ditësh foli nënkryetari i Grupit Parlamentar të CDU-CSU-së, Vadeful. Edhe atë deputet të Lulzim Bashës do ta quash? Ai tha se asnjë nga kushtet nuk është plotësuar.

Erion Braçe – Nuk fola për atë.

Edmond Spaho – Shqipëria nuk ka plotësuar asnjë kusht ...

Erion Braçe – Ti thua nënkryetari i CDU-CSU-së, kurse unë dëgjova një ministër të qeverisë që tha ndryshe.

Edmond Spaho – Edhe ai merret me trafik femrash, siç merrej kryetari i komisionit të punëve të Europës në Bundestag? Edhe për atë, të njëjtën gjë do të thoni?

(Diskutime pa mikrofon)

Unë po them të vërteta. Ju s'i merrni seriozisht. Nënkryetari i CDU-CSU-së ju tha që Shqipëria nuk ka plotësuar kushtet...

(Diskutime pa mikrofon)

... mos u bëj si motra e Skënderbeut! *(I drejtohet një deputeteje që flet pa mikrofon.)*

... për mejhane ke të tjerë edhe i ke me shumicë nga krahu yt...

(Diskutime pa mikrofon)

E keqja juaj është se ju nuk dëgjoni...

Po jua thonë njëri pas tjetrit, që nuk keni plotësuar asnjë kusht për integrimin europian, ju prapë vazhdoni...

(Diskutime pa mikrofon)

Këto janë muhabete mejhanesh. Burra të respektuar me shumë influencë në Europë, të gjithë po thonë se nuk keni plotësuar asnjë kusht.

(Diskutime pa mikrofon)

Data po vjen. T'i rendita me radhë, duke filluar nga koncesionet...

(Diskutime pa mikrofon)

Fakti që po të thonë se nuk ke plotësuar asnjë kusht, do të thotë që Komisioni Europian ... unë nuk kam droje të them që raporti i KE-së, me gjithë reagimet ...

(Diskutime pa mikrofon)

Klevis Balliu – Mos na flisni ju për mejhane. Mejhane ishte ai dekorimi që bëtë dje, edhe ky tipi që keni ju atje për kryetar bashkie, që duhet ndjekur penalisht, se frymëzon banditët dhe kriminelët duke i dekoruar, se bandit ishte Gafurri, se fakti që vdiq nuk e bën kurrë të mirë, banditë ishte dhe ju e dekoruat.

Tani dëgjoni ta mbarojë fjalën deri në fund. Në qoftë se doni të flisni për prokurimet, flisni për ato 47 çështje që ju ka sjellë KLSH-ja dhe s'keni dhënë një përgjigje, flisni për 90% të parregullsive që kanë prokurimet... për këto flisni, për korrupsionin, drogën...

(Diskutime pa mikrofon)

Çfarë Komision Ekonomie jeni ju që s'keni thënë një fjalë për rënien e euros. Rrini dhe dëgjojeni deri në fund!

(Diskutime pa mikrofon)

Erion Braçe – Zoti Balliu, ju lutem shumë, vlerësimet për këtë komision i bën tjetërkush...

(Diskutime pa mikrofon)

Klevis Balliu – Kur shoh përball meje njerëz që frymëzojnë banditë dhe kriminelë, njerëz të cilët bashkëpunojnë me banditë dhe kriminelë, atëherë nuk kam pse t'i respektoj.

Tani dëgjoni kryetarin e Grupit Parlamentar të PD-së! Merrni ndonjë këshillë dhe studiojeni me vëmendje, se nuk ka asnjë akuzë të PD-së, që nuk ju ka dalë e vërtetë. Folëm për Saimirin, ju doli Saimiri. Folëm për Fatmirin, ju doli Fatmiri. Tani dëgjojeni, se ai e di ç'thotë!

(Diskutime pa mikrofon)

Erion Braçe – Kjo mbledhje ndërpritet këtu dhe zoti Balliu nuk hyn më në këtë komision.

Klevis Balliu – Unë hyj sa herë e të dua e ku të dua. Të jesh i sigurt se ti nuk hyn këtu, po nuk desha unë...

(Diskutime pa mikrofon)

Edmond Spaho – Zoti Braçe, prisja që t'i tërhiqnit vëmendjen koleges tënde për fjalën që tha

(Pas pushimit)

Erion Braçe – Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pikërisht me seancën dëgjimore me kandidatët e propozuar nga Këshilli i Ministrave për vendet vakante të anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Ajo që do të dëgjohet e para nga ky komision është zonja Merita Zeqaj.

Zonja Zeqaj, në bazë të propozimit të KM-së, ju jeni këtu për të bërë një prezantim tuajin para këtij komisioni. Do të doja që prezantimi juaj të lidhej me thelbin e punës në Komisionin e Prokurimit Publik.

Natyrisht, pas prezantimit, në rast se ndonjëri nga kolegët ka pyetje për të bërë, do t'ju lutesha që të jeni e hapur për të dhënë përgjigje.

Fjala për ju, për prezantimin tuaj.

Merita Zeqaj – Përshëndetje!

Quhem Merita Zeqaj. Kam mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Arkitekturë, në vitin 1985. Duke qenë se ju e keni CV-në time, unë do të fokusohem shkurt tek puna ime në lidhje me prokurimet publike.

Në periudhën 2002-2010 kam punuar në Agjencinë e Prokurimit Publik, në departamentin e monitorimit si specialiste.

Kam dhënë kontributin tim në këtë departament në shumë aspekte. Jam lektore e prokurimeve publike për njësitë e qeverisjes qendrore, qeverisjes vendore dhe për të gjitha autoritetet e tjera që kryen procedura prokurimi.

Kam asistuar në ndryshimet ligjore që janë bërë në ligjin e prokurimit, kam qenë në grup pune, në dokumentet standarde dhe në rregullat e prokurimit publik.

Pas vitit 2010, Agjencia e Prokurimit Publik u ristrukturua dhe funksionet e ankimimit i kaluan Komisionit të Prokurimit Publik, që u krijua. Unë nuk vazhdova më në Agjencinë e Prokurimit Publik, por punova për 3 vjet në një projekt të BERZH-it për përmirësimet ligjore, për rregullat e prokurimit publik në sektorin utilitar, për 8 muaj dhe pastaj, 2010-2013, si koordinatore e Bankës Botërore pranë Ministrisë së Arsimit për ndërtimin e 22 shkollave në të gjithë Shqipërinë.

Në vitin 2013 rikthehem përsëri në Agjencinë e Prokurimit Publik, në të njëjtin sektor, me të njëjtën performancë pune, në sektorin e monitorimit dhe të kontrollit, me të njëjtën

performancë si lektore, përpunuese dokumentesh, grupe pune për përmirësimet ligjore, asistencë teknike autoriteteve, kontraktore dhe jam këtë, sepse kam pranuar një sfidë, që do të thotë të konkurroj për anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik.

Pse dua unë të konkurroj dhe çfarë lidhje mund të kem me Komisionin e Prokurimit Publik?

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë i vendimmarrjes në shqyrtimin e ankesave në përputhje me ligjin. Po ta shihni në zinxhirin e prokurimit, KPP-ja është në hallkën e mesit, që do të thotë se ai inicohet dhe ingranohet në zinxhirin e prokurimit në momentin kur i paraqitet një ankesë. Cikli i prokurimit është i përbërë nga tri sektorë shumë të rëndësishëm, që janë hartimi i dokumentacioni dhe hartimi i kriterëve për kualifikim dhe vlerësim. Faza e dytë ku KPP-ja vërtet hyn në funksion, është zhvillimi i procedurës, apo gara, kurse faza e tretë është zbatimi i kontratës.

Tani, legjislacioni për prokurimin shqiptar mbështet fazën e dytë, që do të thotë se mbështet zhvillimin e garës së prokurimit publik. Ky është ligji dhe të këto janë gjithë rregullat që dalin në zbatim të ligjit, sepse është faza më e ndjeshme, që përdoret apo kthehet në instrumente politike.

A mund të jap unë kontribut? Patjetër që po. Gjykoj që, duke rritur kapacitetet në fazën e parë, që është faza e planifikimit, do të ndihmoja që si autoritetet kontraktore, ashtu dhe KPP-ja të mund të kryejnë një shqyrtim sa më të saktë të dosjeve, duke u dhënë rëndësinë e duhur që ka hartimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit, pasi një vlerë e shtuar në këtë moment tregon se hallka e dytë, që është zhvillimi i procedurës së prokurimit, do të bëhet mirë dhe hallka e tretë nuk do të ketë shumë kosto në implementimin e kontratës.

Çfarë mund të sjell unë tjetër në fazën e parë të hartimit apo planifikimit të një prokurimi të mirë? Do të inicioja shumë përdorimin e kriterit të vlerës më të mirë ekonomike. Tani për tani, në prokurimet shqiptare, është një përqindje shumë e ulët, për të mos thënë as 1%. Autoritetet kontraktuale dhe KPP-ja nuk e iniciojnë përdorimin e këtij kriteri, që do të thotë se autoritetet kontraktuale kryejnë procedura duke paguar para për një cilësi të mirë. Përdorimi më i mirë i kriterit të vlerësimit është kriteri i çmimit më të ulët. Edhe pse ka bazë ligjore, edhe pse ka dokumente përsëri autoritetet janë shumë të trembura nga auditet dhe nga KLSH-ja në përdorimin e kriterit të vlerës më të mirë ekonomike. Unë e kam mbështetur këtë në leksionet që jap se duhet ta përdorin.

Do të inicioja përdorimin e standardeve. Të përdorësh standarde do të thotë të njohësh mirë specifikimet teknike. Të njohësh specifikime do të thotë të dish se çfarë kërkon. Një autoritet kontraktor, kur e di se çfarë kërkon, di edhe si ta vlerësojë kontratën dhe se si do të zbatohet ajo.

Në këtë kuadër, do të synoja që ngritja e kapaciteteve, qoftë në KPP por edhe me anë të trajnimeve të njësive qendrore apo vendore (unë jam lektore pranë ASK-së prej më shumë se 10 vjet), të bëjë të mundur që autoritetet kontraktore të përmirësojnë punën dhe të kuptonin më mirë se çfarë do të thotë të specifikosh mirë apo të përgatisësh një performancë të mirë të një shërbimi, të një pune apo të një malli. Operatorët potencialë tërhiqen shumë më mirë kur specifikimet janë të sakta dhe të plota.

Do të inicioja përdorimin e blerjeve të përqendruara. Ato rrisin mundësinë e blerjes sa më shumë të produkteve, mallrave dhe të shërbimeve dhe ulin kostot. Blerja e përqendruar ul edhe shpenzimet e prokurimit, sepse nuk janë të shpërndara në autoritete kontraktore, por janë të kërkuara nga një institucion më i specializuar. Gjithashtu, do të krijoj mundësinë që kërkesa për propozim, duke e parë si numër, e cila ka limitet e saj kohore dhe monetare, të jetë procedura më e përdorur në vendin tonë. Vjet janë bërë 4300 procedura kërkesë për prodhim, ndërkohë që tenderët e hapur janë 2000 e ca, domethënë gjysma. Unë do të inicioja krijimin e disa kriteresh standarde, që të kenë si bosht kriteret e mjaftueshme dhe jo kriteret skualifikuese, pra që një procedurë të ketë këto kriteret dhe është e mjaftueshme të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

KPP-ja ka një pozicion shumë të mirë në lidhje me tërheqjen e mendimit të operatorëve ekonomikë, por duhet të krijohet një *database* për informacionin e tyre dhe duhet që të paktën biznesi i mesëm, që merr pjesë në fonde mbi 12 milionë lekë, që janë punë dhe 8 milionë që janë mallra, të mund të përditësohet vazhdimisht me broshura, me ndryshimet që bën Agjencia e Prokurimit Publik, si dhe të familjarizohet me prokurimin publik. Nuk ka një manual apo një broshurë të vogël që t'i familjarizojë ata, prandaj në momentin që paraqet një ankesë, mund t'i jepet një broshurë për këtë gjë.

Erion Braçe – Faleminderit!

A do të na jepni edhe ne mundësinë të pyesim?

Merita Zeqaj – Po, patjetër.

Erion Braçe – Unë kam dy pyetje: së pari, meqë ju keni përvojë pune në APP dhe meqë këtu ka një debat të vazhdueshëm, a ka mundësi t’i vëmë fre ose ta vëmë nën kontroll procedurën me negociim? Si mund të ndikojë KPP-ja si institucioni më i lartë i vendimmarrjes në piramidën e prokurimit publik në këtë aspekt, me qëllim që ta vërë nën kontroll dhe të mos dalë jashtë kontrollit? Unë e kuptoj që ka njerëz këtu që as i hyjnë kësaj historie dhe as që duan t’ia dinë, se janë sipërfaqësorë, por në momentin që ka nisur një procedurë prokurimi dhe në spital ka një nevojë urgjente për ilaçe, do të duhet që ta negociosh blerjen e atyre ilaçeve. Por këta nuk e kuptojnë. A ka mundësi që kjo të rregullohet dhe të kufizohet vetëm në ato raste që është jetike? Cili mund të jetë roli i APP-së në këtë pikë?

E dyta që kam, ju sot jeni punonjëse e APP-së, keni punuar më herët në institucione ndërkombëtare dhe tani kaloni në një nivel tjetër vendimmarrës, që është Komisioni i Prokurimit Publik. Dua t’ju pyes drejt, a jeni e zonja të ruani pavarësinë jo vetëm politike, por edhe institucionale, brenda institucionit ku do të bëni pjesë si anëtare dhe pavarësinë përkundrejt operatorëve ekonomikë, që janë shumë të interesuar për vendimmarrjen e KPP-së?

Urdhëroni.

Merita Zeqaj - Lidhur me procedurat “negocim pa shpallje” ato kanë një lloj historiku shumë të errët. Fillimisht i miratonte APP-ja, pastaj u bë ndryshimi ligjor dhe autoriteteve kontraktuale iu lanë të gjitha të drejtat, por autoritetet abuzojnë. Të gjithë e dimë që në kontratat e fillimvitit aplikohet baza ligjore dhe ato do të vazhdojnë të blejnë mall, apo të kryejnë shërbimet që kanë në vijim. Këtyre ne u kemi dhënë një emër tjetër me ndryshimet e fundit ligjore, i kemi quajtur amendime të fillimvitit. Por a mund të reduktojmë përdorimin e procedurave kryesisht në shtesat e kontratave për punë, që mund të jepen vetëm në situata të paparashikuara për Autoritetin Kontraktuar? Mundohen dhe justifikohen shpesh me mosnjohjen e zonës ku implementohet një kontratë. Gjykoj se këndvështrimi duhet të jetë akoma më i thellë dhe ju, por edhe Këshilli i Ministrave duhet ta shihni më gjerë ngritjen e një strukture për *check-imin* e projekteve për të parë a kemi rrisqe në një implementim pune? Patjetër, por sa më me pak kosto. Projektet e vitit 2011 tenderohen edhe sot.

Tani është krijuar dhe regjistri *online* dhe negociimet pa shpallje futen në regjistër. APP-ja ka futur një fjalë në rregullat e prokurimit publik që nuk i pranon si element regjistri nëse nuk i kanë deklaruar të gjitha kushtet. Ato i deklarojnë ligjërisht siç ua kemi dhënë ne udhëzimin, por duhet të paraqesin edhe gjendjen. Në fakt, gjendja, në përqindjen më të madhe të asaj që shoh

dita ditës është mospërditësimi apo mosrinjohja e kushteve të zbatimit të projektit. Ka një ngërç shumë të madh që tek hartimi i projektit e deri të hedhja në tender. Vërtet kjo mund të marrë kohë, por ama duhet të kemi një institucion, një departament apo një drejtori që t’i kontrollojë këto, ose brenda APP-së ose një institucioni tjetër financiar, që ka kapacitete me inxhinierë, juristë dhe ekonomistë, që të infiltrojnë negocimet dhe të jepeshin vetëm në ato momente kur janë të justifikuara, ose situata emergjente.

Erion Braçe – Pyetja e dytë.

Merita Zeqaj – Po. A jam e zonja të mbaj pavarësinë e institucionit?

Kjo është e qartë në ligj.

Erion Braçe – Unë jam shumë i qartë se çfarë ka ligji, por dua ta di dhe ta dëgjoj nga ju, zonjë.

Merita Zeqaj – E qartë. Unë do të respektoj ligjin. Gjithçka me integritet. Unë nuk kam pse jap informacion para se të dalë një kualifikim apo para se të shqyrtohet një procedurë, sepse do të shkelja ligjin, apo do të diskutoja për një gjë.

Erion Braçe – Zonjë, unë jam kryetar i Komisioni të Ekonomisë dhe ju, si Komisioni i Prokurimit Publik vareni nga ne. E zëmë se do t’ju marr unë në telefon, çfarë do të bëni ju zonjë?

Merita Zeqaj – E para, për edukatë do t’ju dëgjoja.

Erion Braçe – Patjetër që do të më dëgjoni.

Merita Zeqaj – Sepse po i bini telefonit. E dyta, do t’ju tregoj se do të zbatoj ligjin.

Erion Braçe – Faleminderit!

Zonja Dhima keni fjalën.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për prezantimin!

Në CV-në tuaj shoh se keni goxha eksperiencë në prokurimet publike. Unë do të të bëj dy pyetje.

Pyetja e parë, a mendoni dhe gjykoni se ligji për prokurimin publik ka nevojë për ndryshime?

E dyta, çfarë mund të bëni ndryshe nga stafi ekzistues i Komisionit të Prokurimit Publik për kthimin e përgjigjeve dhe për respektimin e afateve të ankesave që bëjnë entet prokuruese, pasi dihet shumë mirë se ka shumë shtyrje të afateve dhe, në vijim edhe të fjalës së kryetarit të

komisionit, entet prokuruese detyrohen të bëjnë negociime pas negociimesh, për shkak të nevojave dhe të emergjencave që kanë këto institucione në realizimin e misionit të tyre?

Faleminderit!

Merita Zeqaj – Faleminderit!

“A gjykoni se ligji për prokurimet ka nevojë për ndryshime?” Ligji është pothuajse i përafruar me direktivën 2004, fillon te 19-a dhe mbaron te 24-ra. Vetëm në disa pjesë do të gjykoja se mund të ndryshonte, të shqyrtimi i ofertave. Te shqyrtimi i ofertave, ku janë aktet rregullatore ato që përmirësojmë, të mund të hiqej oferta nominalisht e ulët. Oferta nominalisht e ulët ka dalë jashtë çdo parashikimi. Autoritetet kontraktore jo vetëm që nuk e njohin dhe nuk e respektojnë, ashtu siç e kërkojnë rregullat e prokurimit, por kanë edhe një performancë prepotente. Në qoftë se ne u themi se oferta del anomalisht e ulët dhe ti duhet të komunikosh për elementet specifike që ai ka paraqitur në ofertë, ai nuk bën gjë tjetër, veçse thotë se do të më sjellësh një numër x analizash të zërave të preventivit. Nëse ti nuk ke sjellë këtë x , por ke sjellë $x-1$, ti je i skualifikuar. Ky nuk është një argument ligjor për të skualifikuar një operator ekonomik nga një procedurë. Ajo të hiqet dhe të vendoset një dysHEME dhe me këta operatorë që dalin poshtë kësaj dysHEMEJE, të mos merreshim fare, të quhet e skualifikuar.

“Çfarë mund të bëni për ndryshimin e afateve?” Nuk dua të paragjykoj asnjëri, por është për të ardhur keq që Shërbimi Social Shtetëror, po jua jap me shembull, sepse ju jeni të informuar shumë herë më mirë se unë, për një procedurë, për 8 institucione të varësisë së tij, për furnizimin me ushqime, KPP-ja ka ndërhyrë dhe ka 2 muaj që e ka pezulluar. Afatet e ankimimit kanë mbaruar dhe unë kam shkuar atje dhe ata kërkojnë negociimin pa shpallje, sepse janë institucione shumë delikate, janë institucione që duhet të mbahen me këtë lloj shërbimi dhe vazhdon të jepet negociim. Absolutisht, do të insistoja shumë në respektimin e afateve, në kthimin e përgjigjeve. Nuk shkon një procedurë pa fund, sepse çdo gjë ka kosto.

Erion Braçe – Faleminderit, zonjë!

Jeni e lirë të largoheni.

Merita Zeqaj – Faleminderit!

Erion Braçe – Të vijë zoti Deva...

(Pas pushimit)

Erion Braçe - ...Komisioni, për të bërë një prezantim tuajin pas propozimit të Këshillit të Ministrave, për të qenë një nga kandidatët e mundshëm në Kuvend për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Do t'ju lutesha të bënit një prezantim. CV-ja juaj u është shpërndarë kolegëve. Donim të dinim më shumë rreth vizionin tuaj për Komisionin e Prokurimit Publik. Keni 10 minuta kohë. Më pas edhe kolegët tanë deputetë mund t'ju adresojnë pyetje.

E keni ju fjalën.

Gentian Deva – Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Quhem Gentian Deva. Kam mbaruar studimet në vitin '95 pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Menjëherë pas përfundimit të studimeve kam vijuar në një studio ligjore për hartimin e akteve të themelimit të statuteve të shoqërive të reja që krijoheshin. Kuptohet, ishin vitet '95-'96 dhe ishte e vështirë të krijoheshin shoqëri shqiptare. Kishin vështirësi edhe kompanitë e huaja, që vinin në Shqipëri. Me fillimin e punës në këtë studio, u njoha edhe me kompanitë e huaja italiane, që erdhën në Shqipëri dhe me to vijova të punoj për rreth 10 vjet, edhe pse më tej isha konsulent i jashtëm i këtyre kompanive. I ndihmoja këto kompani në gjetjen e tregut në Shqipëri dhe në marrëdhëniet me institucionet shtetërore në Shqipëri. Menjëherë pas përfundimit të këtyre punëve, bashkë me kompanitë italiane, të cilat rreth vitit 2005 filluan të tërhiqeshin nga Shqipëria për arsyet e tyre, gjeta hapësirat dhe konkurrova pranë Bankës së Shqipërisë në rolin e përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve, pozicion që e mbajta për 7 vjet. Gjatë kësaj kohe, Banka e Shqipërisë pati një ekspansion, një kërkesë të madhe për rritjen e kapaciteteve të brendshme infrastrukturore dhe kjo reflektohej në punën e Sektorit të Prokurimeve. Pra, aty patëm procedura jashtëzakonisht të veçanta, siç ishte procedurë e veçantë edhe konkursi i realizimit të projektit të Bankës së Shqipërisë, që ishte një procedurë e realizuar në bashkëpunim me Banca d'Italia në Itali. Ishte një eksperiencë shumë e mirë. Pas 7 vjetësh punë si përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, arrita të marr edhe pozicionin e kryetarit të Komisionit të Prokurimit të Bankës së Shqipërisë, pozicion që e mbajta për rreth 3 vjet.

Si kryetar i Komisionit të Prokurimit të Bankës së Shqipërisë, kisha si objektiv kryesor timin objektivin që e kisha edhe më parë si përgjegjës: realizmin brenda afateve të të gjitha procedurave të prokurimit, të përcaktuara për t'u realizuar brenda vitit, duke bërë të mundur që investimet të realizoheshin në afatet e duhura dhe buxheti i institucionit të realizohej brenda afateve të përcaktuara nga vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Pas vitit 2005 u tërhoqa nga Banka e Shqipërisë për të punuar aty ku punoj aktualisht, në një studio kontabiliteti, të cilën e kam ngritur vetë dhe jam konsulent fiskal, tatimor, për mbajtjen e kontabiliteti dhe mbylljen e pasqyrës financiare vjetore të shoqërive të ndryshme tregtare shqiptare.

Duke punuar së bashku me kompanitë shqiptare, pashë në faqen e APP-së vendimin që kishte dalë për të aplikuar si anëtar i Komisionit të Prokurimit dhe meqë kisha eksperiencën e duhur për ta bërë këtë punë, mendova se do të ishte e mundur të kaloja këtu.

Kjo ishte një pasqyrë e shkurtër e punës.

Vizioni im për Komisionin e Prokurimit Publik është shqyrtimi i domosdoshëm dhe brenda afateve të përcaktuara në legjislacion i të gjitha ankesave të ardhura pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Në qoftë se kjo arrihet, kuptohet që do të ishte në të mirë të të gjitha shoqërive, që kanë kostot e tyre, por sidomos të realizmit të buxhetit brenda afateve të përcaktuara në legjislacion.

Kjo ishte një pasqyrë e shkurtër.

Faleminderit, kryetar!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Deva!

Kam një pyetje. Nga CV-ja juaj shoh se që nga viti 2005 deri në vitin 2012 keni qenë përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve në Bankën e Shqipërisë dhe pastaj me radhë, nga 2012-2015, apo jo?

Gentian Deva – Po.

Erion Braçe – Unë dua t'ju pyes (mbase ka qenë jashtë përgjegjësisë suaj në Bankë) për dy çështje:

Së pari, për prokurimin e rikonstruksionit të godinës së Bankës së Shqipërisë.

Së dyti, për procedurën e blerjes së hotel “Dajtit”.

Cili është mendimi juaj?

Gentian Deva – Në momentin kur është bërë rikonstrukcioni i Bankës së Shqipërisë, kam qenë përgjegjës i Sektorit të Prokurimit të Bankës së Shqipërisë. Unë dhe specialistët jemi marrë me hartimin e dokumentacionit të përcaktuar nga Komisioni i Prokurimit për realizim e ndërtimit të Bankës së Shqipërisë. Pra, vendimet merren nga Komisioni i Prokurimit të Bankës së Shqipërisë, ndërsa Sektori i Prokurimit kishte detyrën e hartimit të dokumentacionit.

Erion Braçe – Domethënë, ka qenë komision tjetër ai që ka marrë vendimin për fituesin?

Gentian Deva – Po, është Komisioni i Prokurimit. Pra, Banka e Shqipërisë ka kryetar të vetin...

Erion Braçe – E kuptova.

Po për blerjen e hotel “Dajtit”?

Gentian Deva – Për blerjen e hotel “Dajtit”, pasi doli vendimi i Këshillit të Ministrave të asaj kohe për shitjen e pronës, është marrë një vendim. Është marrë mendimi i ekspertëve të Banca d’Italia, që asistonin në realizimin e godinës qendrore të Bankës së Shqipërisë. Ishte drejtori i administrimit të Banca d’Italia, i cili erdhi në Shqipëri dhe e pa godinën. Menduam se do të ishte një gjë e mirë, meqenëse Banka e Shqipërisë, që nga viti ’98, kërkonte të blinte ambiente. Menduam të blihet ky ambient, pa parë kostot që kishin dalë. Për sa u përket kostove të godinës, ose të të gjithë pronës, ishte një vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe procedura është bërë e gjitha nga departamenti i administrimit, nga Sektori i Prokurimit për Hartimin e Dokumentacionit dhe Komisioni i Prokurimit. Në këtë rast, prapë ka qenë një komision tjetër i veçantë.

Erion Braçe – Çfarë mendoni ju për atë procedurë? Keni ndonjë opinion tuajin për atë procedurë?

Gentian Deva – Për sa i përket vendimit të marrë për këtë procedurë, nuk është vendim që mund ta marr unë, ndërsa për sa i përket procedurës, se si është realizuar ajo, mendoj se është shumë e saktë. Pra, për blerjen e hotel “Dajtit” ka një vendim të Këshillit të Ministrave. Është një vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për blerjen e pronës. Për sa i përket procedurës së prokurimit, është një tjetër procedurë. Pra, siç blihen stilolapsat, blihet edhe një pronë. Ka të njëjtat procedura.

Erion Braçe – Dakord, por stilolapsat nuk fillojnë nga qeveria, sidomos në Bankën e Shqipërisë, sidomos kur duhet të blejë Banka e Shqipërisë. Nuk fillojnë nga qeveria. Kjo është diferenca. Prandaj ju pyeta, për të ditur më shumë.

Zoti Bushati, urdhëroni!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Me sa mbaj mend, vlera është rreth 30 milionë euro. Mbahet mend kollaj, sepse është një shifër e madhe, e bukur, e rrumbullakosur, si u arrit deri në identifikimin e shifrës për privatizim?

Erion Braçe- Zoti Bushati, po ju përgjigjem unë. Shifra u identifikua nga qeveria dhe iu dërgua bankës.

Ervin Bushati- Çfarë kushtesh kualifikimi ka, atëherë? Unë e di se bëhet në bazë të kërkesës, jo në bazë të ofertës.

Gentian Deva- Vlera 30 milionë euro doli sipas një mendimi të marrë nga qeveria e Shqipërisë së asaj kohe, bazuar në një raport vlerësimi të një eksperti të pronave me licencë të pavarur. Pra, ky vendim, së bashku me vlerësimin e pronës erdhi pranë Bankës së Shqipërisë dhe u shtrua në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për blerje. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi blerjen dhe shtesën në buxhet të fondeve për 30 milionë euro, siç ishte vendimi i qeverisë. Gjithsesi, procedurat e mëtejshme ishin të njëjta me procedurat e prokurimit.

Ervin Bushati- Më falni, procedurat e mëtejshme mund të jenë të gjitha të rregullta, por kur premisa ose gjeneza është e kalbur mua nuk më duket se mund të vazhdohet me një procedurë hua, ku as nuk respektohet pavarësia institucionale, nuk mund të imponohet shteti, aq më tepër Banka e Shqipërisë, e cila duhet të jetë tërësisht e pavarur sidomos në ekonomi tregu, në kapitalizëm. Më falni, nëse është kërkuesi është ai që del në treg dhe kërkon, nuk mund t'i imponohet shitësi, imponohet blerësi në kapitalizëm, në socializëm mund të kenë qenë këto procedura.

Erion Braçe- Më falni, zoti Bushati, zotëria nuk ka lidhje me këtë pjesë, ka një vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që duhej hetuar nga prokuroria dhe që duhet të kishte bërë detyrën deri në fund për këto që janë konstatime komplet të drejta jo vetëm tuajat, por edhe të KLSH-së.

A ka ndonjë pyetje tjetër?

Atëherë, shumë faleminderit, zoti Deva për prezantimin tuaj.

Vazhdojmë me zonjën Enkeleda Bega

Për shkak të propozimit të bërë nga Këshilli i Ministrave pranë këtij Kuvendi, jeni e ftuar të bëni një prezantim tuajin, CV-në tuaj kolegët e kanë përpara, do të doja më tepër një vizion tuajin lidhur me prokurimet publike dhe me rolin ose funksionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Pastaj do t'ju lutesha të prisni pyetje nga kolegët për të kthyer përgjigje.

Fjalën e keni ju, 10 minuta, për prezantimin tuaj.

Enkeleda Bega- Kam përfunduar studimet e larta për Drejtësi në vitin 2004, pranë Fakultetit të Drejtësisë në Tiranë, dhe pas kësaj kam filluar punë në Bashkinë Memaliaj si juriste, për të vijuar më vonë me punësimin pranë një kompanie ndërtimi si juriste dhe më vonë si avokate, pasi u pajisa me licencën e avokatisë në vitin 2006. Për dy vjet rresht kam punuar në kompani ndërtimi, sepse në vitin 2008 kam filluar si specialiste e akteve ligjore pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, njëkohësisht edhe si specialiste e prokurimeve për shkak se Autoriteti nuk kishte njësi prokurimi të përhershme, e cila krijohet në fillim të çdo viti me një urdhër të posaçëm. Kam pasur 2 vjet e gjysmë shkëputje nga prokurimet nga viti 2014 deri në dhjetor të vitit 2016 për shkak të punës në Kosovë pranë misionit të BE-së, EULEX, ku kam punuar si këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë, pastaj kam vijuar me punësimin tim pranë kompanisë “AdriaticLines” në pozicionin e specialistes së prokurimeve për Shqipërinë.

Sa u përket studimeve universitare dhe pasuniversitare, zotëroj një diplomë juristeje, shoqëruar me licencën e avokatit. Kam mbaruar studimet pasuniversitare në vitin 2013 pranë Institutit të Studimeve Europiane për politikën dhe qeverisjen në BE. Gjithashtu, kam bërë disa trajnime *online* në fushën e prokurimeve, të certifikuara nga Banka Botërore, për menaxhim kontratash dhe prokurimet publike.

Erion Braçe – Meqë ju punoni pranë TAP-it si specialiste prokurimesh, do të doja të dija nëse prokurimet që bën TAP-i për shërbimet i nënshtrohen legjislacionit tonë apo rregullave?

Enkeleda Bega- Ka rregullat e veta.

Erion Braçe – Atëherë, meqë ju njihni edhe legjislacionin tonë, edhe rregullat e TAP-it, cila është diferenca midis prokurimeve që bën një kompani konsorciumi kaq e madhe, si TAP-i, dhe prokurimeve që bëhen nga entet prokurorese në Shqipëri, sa i përket legjislacionit dhe sa i përket praktikës?

Enkeleda Bega- Parimet janë të njëjta, ai që ndryshon është implementimi. Rregullat e prokurimeve të TAP-it janë më shumë fleksibël se ligji shqiptar për prokurimet.

Erion Braçe- Në çfarë kuptimi janë fleksibël?

Enkeleda Bega- Le të themi që në ligjin e prokurimit shqiptar marrim ofertën më të ulët të preferuar për të nënshkruar një kontratë, ndërkohë që rregullat e TAP-it thonë se duhet të jetë kombinim i cilësisë, i kostos, shpërndarjes së shërbimit dhe i çmimit, që jo domosdoshmërisht rezultojnë me ofertën më të ulët.

Antoneta Dhima- Në fjalën tuaj ju theksuat se keni punuar si kryetare e komisionit të prokurimeve publike në Postë. A keni pasur aty raste anikimimi për procedurat që ju keni kryer dhe sa nga këto raste kanë qëndruar në fuqi?

Enkeleda Bega- Unë kam qenë specialiste prokurimesh dhe jo kryetare e komisionit.

Antoneta Dhima- Po anëtare e komisionit a keni qenë?

Enkeleda Bega- Jo, asnjëherë.

Ervin Bushati- Në këtë post kërkohet një cilësi integriteti të lartë, si profesional dhe moral, dhe ka të bëjë edhe me motivimin. Unë e shoh me një rritje të qëndrueshme CV-në tuaj në nivelin profesional dhe normale që kërkoni të shkoni në këtë nivel. Keni pasur eksperiencë, por unë kam një pyetje: a e justifikon largimin nga një institucion privat, që mund të ketë një rrogë më të mirë, për të kaluar me një rrogë shteti? Pra, a ju intereson juve që të kaloni nga një rrogë privati në një rrogë shteti? Ju keni disa vite që keni rroga të mira.

Enkeleda Bega – Projekti përfundon në dhjetor të vitit 2019 dhe pritet të bëhet operacional në janar të vitit 2020, kështu që për një vit e gjysmë kemi garanci që mund të jemi në projekt. Nuk është kjo arsyeja pse unë kam aplikuar për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak se unë kam 14 vjet eksperiencë pune dhe 12 vjet në prokurime, e cila kombinuar me *bachkgraund-in* tim ligjor do të më ndihmonte në rritjen time profesionale. Nëse deri tani kam qenë në të dy anët e procesit të prokurimit, tani do të jem mbi palët dhe mendoj se kjo është një eksperiencë që unë dua ta provoj.

Ervin Bushati- Nuk e di a më kuptuat, ndoshta rrogën e keni më të lartë të privati, a nuk është ky motivim?

Enkeleda Bega- Nuk është motivim, për më tepër, nuk është se ka ndonjë ndryshim.

Erion Braçe- Është krijuar një ide tjetër për privatin sikur paguan shumë para.

A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Faleminderit shumë, zonjë!

Të vijë kandidati tjetër!

Rifillojmë mbledhjen.

Zonja Zhupaj, jeni këtu për shkak të propozimit të ardhur nga Këshilli i Ministrave në Kuvend, ku ju nominoheni për të qenë një nga kandidatet e mundshme për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimeve Publike. Do të donim një prezantim tuajin. CV-në tuaj e kemi. Do të donim të dinim, për shkak edhe të përvojës që reflektoni në CV-në tuaj, një ide tuajën për prokurimet publike në këtë vend, por, mbi të gjitha, një ide tuajën për funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Pastaj do t'u përgjigjeni pyetjeve që mund të kenë kolegët.

Vilma Zhupaj- Faleminderit!

Kam përfunduar studimet e larta për drejtësi, si dhe studimet master për shkencat administrative. Kam filluar punën në Bashkinë e Patosit në vitin 2008, ku kam qenë specialiste në fushën e shërbimeve, më pas kam kaluar përgjegjëse e njësisë së prokurimeve dhe nga shtatori i vitit 2011 e në vazhdim jam zëvendëskryetare e Bashkisë së Patosit.

Arsyeja që unë kam aplikuar për të qenë anëtare e Komisionit të Prokurimit është pikërisht përvoja ime në fushën e prokurimeve. Siç thashë, kam nisur punë në vitin 2008 në një vit kur ka nisur reforma për prokurimet publike. Në janar të vitit 2009 kishim një legjislacion, ku procedurat e prokurimit duhet të realizoheshin në formë elektronike. Që këtu fillon një zbatim shumë i madh i parimit të transparencës në fushën e prokurimeve.

Mendoj se tashmë ne mund të shohim shumë mirë në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik apo në faqen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertës, në Komisionin e Prokurimit Publik, mund të njihemi me autoritet kontraktore, të cilat hedhin procedurat e prokurimit publik, me vlerat e tyre, me kriteret, dokumentacionin ligjor që duhet të plotësojnë operatorët dhe, në anën tjetër, kemi faqen e Komisionit të Prokurimit Publik, ku secili nga ne mund të klikojë dhe të shohë *online* ankesat e operatorëve, gjithashtu, mund të njihet edhe me vendimet. Ajo që mendoj se është e rëndësishme në të gjithë fazën, sepse flasim për proces ankimimi dhe, po të shohim faqen e Agjencisë, ajo që mendoj se mungon aktualisht është një **model**, një manual për procedurat e prokurimit. E them shpesh këtë gjë për faktin se po shohim gjatë gjithë kohës se edhe në raportet e Komisionit të Prokurimit mund të ketë më shumë sesa 50 operatorë, të cilët nuk vlerësohen për ankesat e tyre, sepse nuk plotësojnë elemente të anës formale. Kjo jo vetëm për fazën e fundit, por duhet menduar edhe për pjesën e fillimit, sepse aty lind problemi. E mendoj në këtë formë, pasi nëse ne si Autoritet Kontraktor do të marrim një ankesë nga

operatorët, do të shohim se ata nuk e plotësojnë në fillim formularin standard të ankesës, madje janë shumë konfuz edhe në përfundim të procesit se çfarë kërkojnë, çfarë pretendojnë dhe se çfarë shkeljeje ligjore mendohet se është në këtë rast. Nga ana tjetër, ka shumë autoritete kontraktore, të cilët nuk e zbatojnë parimin e transparencës, por thjeshtë bëjnë atë që operatori nuk i plotëson kriteret pa përcaktuar qartë se çfarë kriteresh nuk plotësohen dhe cila është shkelja ligjore në këtë rast.

Pra, duke menduar se kjo ka një rëndësi shumë më të madhe për operatorët ekonomikë, e them në këtë formë, pasi jo vetëm që ankesa nuk shqyrtohet në fazën përfundimtare, por këta operatorë do të humbasin edhe vlerën dhe tarifën e ankimimit që është 0,5% e vlerës, por kjo gjithsesi është në varësi të llojit të ankimimit. Mendoj se kjo është fillesa dhe është mjaft e rëndësishme për të pasur një manual që nga fillimi e deri në përfundim të procesit, derisa operatorët ekonomikë mund të ankimojnë edhe vendimin e KPP-së në Gjykatën Administrative.

Ajo që mendoj se është mjaft e rëndësishme për Komisionin e Prokurimit është fakti se ai nuk duhet të mbetet vetëm te legjislacioni dhe shqyrtimi i ankesës. Pra, procesi nis me shqyrtimin e ankesës së operatorit dhe përfundon me kontrollin e ligjshmërisë. Flitet për ankesa dhe shqyrtime pa fund, por ajo që mendoj se është e rëndësishme është që Komisioni i Prokurimit Publik, duhet të jetë iniciatori për ndryshimet ligjore. Për mua sot problemi është rezultati. Komisioni i Prokurimit nuk duhet të mbetet vetëm te pjesa e ligjit për shqyrtimin e çështjes, por duke pasur një problematikë, duke i identifikuar këto problematika në fushën e prokurimeve publike, mendoj se duhet të jetë iniciatori për ndryshime.

Për sa i takon pjesës së fundit, mendoj se ajo që duhet të jetë shumë e rëndësishme për Komisionin e Prokurimit, të gjitha autoritetet dhe operatorët ekonomikë përfundimin e procesit ose vendimit e komisionit e shohin si licencim ose certifikim të procesit të ligjshmërisë. Në qoftë se ne bëjmë një analizë të një dosjeje ku vendimin e komisionit ta shohim të parin dhe të themi se ky proces është i kontrolluar, ne në shumicën e rasteve e përdorim këtë vendim si model për shqyrtimin e rasteve të ngjashme dhe për këtë arsye Komisioni i Prokurimit Publik për të njëjtat çështje duhet të ketë një unifikim vendimesh, por jo vetëm kaq, por mendoj se duhet të ishte mjaft i rëndësishëm edhe një bashkëpunim institucional.

Një bashkëpunim institucional me të gjitha organet që merren me shqyrtimin e prokurimeve do të sillte një mirëfunksionim dhe mirorganizim të legjislacionit për prokurimet. Nga njëra anë kemi Agjencinë e Prokurimit Publik, Komisionin e Prokurimit Publik dhe në

përfundim është Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili po ashtu bën kontrollin e procesit të prokurimit. Në të gjitha rastet ka ndodhur shpesh që edhe Agjencia e Prokurimit Publik në vendimet e saj për të njëjtat çështje nuk i ka pasur të njëjta. Pra, në qoftë se do të vazhdohet në këtë mënyrë dhe nuk do të kihet një bashkëpunim ndërmjet institucioneve që bëjnë kontrollin e ligjshmërisë të një procesi, atëherë mendojmë se nuk është rregulluar sistemi në tërësi, por gjatë gjithë kohës autoritetet kontraktore do të mendojnë se kanë ata të drejtë, operatorët ekonomikë do të mendojnë se kanë ata të drejtë dhe asnjëherë nuk do të gjendet një lexim apo një interpretim i mirë i legjislacionit për prokurimet.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit juve për të gjitha ato që thatë!

Unë kam një pyetje. Ne kohë pas kohe kemi vlerësime nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për Komisionin e Prokurimit Publik dhe veprimtarinë e tij dhe vendimmarrjen e tij në kohë të ndryshme. Pikërisht për këtë arsye një pjesë e atij komisioni që rikandiduan pranë këtij komisioni për të qenë po prapë atje, nuk janë më, prandaj doja të dija mendimin tuaj si palë, sepse keni punuar me prokurimin publik pranë enteve prokuruese, për një gjë që shkon keq në Komisionin e Prokurimit Publik? Vetëm një.

Vilma Zhupaj – Ajo që unë mendoj është se nuk duhet të ngelet vetëm te zbatimi dhe të marrë mision vetëm nëpërmjet procesit të ankimimit të operatorit dhe kontrollit të ligjshmërisë. Realisht e vlerësoj punën e tyre, sepse mendoj që është një komision i rëndësishëm, që përkthehet në certifikim procesi ligjshmërie, në efektivitet fondesh në lidhje me vendimin që marrim, por mendoj se duhet të bëjnë identifikim problematikash. Kjo është ajo që unë e mendoj si gjënë më të rëndësishme dhe nuk duhet të merren me objektin e ankesës, por duhet të jetë ajo iniciatorja për ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik dhe mos të ngelet thjeshtë në kuadrin e bashkëpunimit me Agjencinë e Prokurimit Publik, por gjithçka duhet të shkojë më lartë.

Erion Braçe – Pyetja e dytë, të cilën ia bëra edhe njërës prej kolegeve tuaja. A e keni mundësinë të ruani pavarësinë jopolitike, sepse kjo nuk diskutohet fare në institucionin ku ju jeni, pavarësinë institucionale, të ruani rolin tuaj si anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik i pandikuar nga katër anëtarët e tjetër, duke përfshirë edhe kryetarin e këtij komisioni, apo nga operatorët dhe të njohurit e operatorëve ekonomikë? A e bëni dot këtë gjë?

Vilma Zhupaj – Sigurisht që po. Mendoj se po të jesh lexuese e mirë e ligjit për prokurimin, aty është e shprehur qartë lidhja me pavarësinë e anëtarëve të komisionit dhe kjo sipas mendimit tim lidhet me pjesën e transparencës. Në komision, unë kam pasur ankesa për procedurat e prokurimit në institucionin që punoj. Kjo realizohet më së miri. Pra, nëse sot flasim për ta çuar informacionin apo të gjithë dokumentacionin ligjor nga ana e autoriteteve kontraktore në njërën anë, të cilët mendojnë se kanë të drejtë për procesin, nga ana tjetër operatori ekonomik me të drejtë paraqet po të njëjtin dokumentacion me bindjen se është ai që ka të drejtë për procesin, në këtë rast autoriteti dhe operatori ekonomik ballafaqohen ose anëtari i komisionit bën ballafaqim faktesh. Pra, nuk ka lidhje nëse ai do të jetë prezent apo jo gjë që e shohim shpesh, por bëhet ballafaqim faktesh dhe provash, prandaj mendoj se kjo realizohet.

Erion Braçe – Për shembull, ju më njihni mua, por njihni edhe Xhevitin.

Vilma Zhupaj – Po.

Erion Braçe – Po t'ju marrim ne në telefon, çfarë do të bëni ju?

Vilma Zhupaj – Për mirësjellje do ta hapja, por për procesin në mënyrë absolute, jo.

Erion Braçe – Pyetja e fundit. A mendoni se mbledhjet vendimmarrëse ku bëhet diskutimi i fakteve rreth një dosjeje të caktuar të Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jenë të regjistruara?

Vilma Zhupaj – Po, besoj se mund të jetë një zgjidhje e mirë që të sigurohet besimi i vërtetë publik në tërësi, qoftë nga autoritetet, sepse jemi duke folur për prokurimet dhe ndikimi i tyre është shumë i madh, prandaj mendoj se po.

Erion Braçe – Faleminderit!

Zonja Gjylameti, e ka fjalën.

Blerina Gjylameti – Duke e falënderuar zonjën për prezantimin dhe për përgjigjet që dha, kisha një pyetje, e cila është ndryshe. Në qoftë se ju merr në telefon një deputet, si do të përgjigjeshit?

Në përgjigjen tuaj ju thatë se ligji është shumë i qartë, në qoftë se e lexon atë, sigurohet integriteti i vendimmarrjes suaj. Në qoftë se kryetarja e komisionit, ajo nga e cila ju do të vareni më pas, ju kërkon që ju të merrni një vendim në harmoni me vendimmarrjen e anëtarëve të tjerë të komisionit, si do të vepronit? E para.

E dyta, nuk besoj se të tjerët nuk dinë ta lexojnë ligjin, të gjithë dinë ta lexojnë ligjin, ai është shumë i qartë. Në këndvështrimin tuaj, duke vlerësuar çfarë ka ndodhur më përpara dhe duke menduar se do të sillni një ndryshim, çfarë duhet ndryshuar aty?

Sot që jemi duke folur, ajo që bën Komisioni i Prokurimit është pikërisht të vendosë, pra është një formë gjykate të themi, se kush ka të drejtë. Në mendimin tuaj a ka diçka që duhet ndryshuar për ta përmirësuar ligjin, që fokusi të mos jetë vetëm thjesht një gjykatës që vlerëson se cila nga palët fiton po të ketë ndryshime mbi atë që është interesi i përgjithshëm, pra shpenzime efektive të parasë publike? Si mendoni ju për këto dy pyetje?

Vilma Zhupaj – Për sa i takon vendimmarrjes, unë kam qenë dhe jam kryetare apo anëtare e komisionit të vlerësimit të ofertave në institucionin ku punoj dhe po ta marr në të njëjtin prizëm, edhe për Komisionin e Prokurimit Publik është një shkallë ankimi ku procesi pothuajse është i njëjtë, prandaj mendoj se ajo që është e vlefshme dhe ku bazohet secili prej nesh është vlerësimi real, i pandikuar në mënyrë absolute qoftë si anëtar, qoftë si kryetar apo çfarëdo që të jesh për vendosmërinë për një procedurë prokurimi. Gjatë gjithë kësaj faze nuk kam qenë e ndikuar apo të kem pasur ndikime asnjëherë nga procedurat e prokurimit dhe mendoj se edhe nëse do të më besohej një detyrë e tillë, do të isha e paanshme ndaj ndikimeve të tilla. Për sa i takon faktit të jesh lexues i mirë i ligjit, e theksoj shumë këtë, sepse mendoj se për të njëjtën çështje mund të jepen interpretime të ndryshme. Kryetari i komisionit sot nëse mua më besohet kjo detyrë, mund të mendojë ta interpretojë atë pikë të ligjit ndryshe nga unë, por kjo nuk do të thotë se unë nuk kam të drejtë ta kundërshtojë këtë gjë me fakte dhe prova pjesë të procesit. Ne sot kemi parë se edhe në Komisionin e Prokurimeve Publike ka pasur vendime kundër, të cilat janë shumë të mirargumentuara dhe nuk janë ndikuar nga fakti i të qenurit anëtar, apo nga ndikimi i kryetarit ose i ndonjë anëtari tjetër. Unë besoj se vendimmarrja është personale, duke u bazuar në fakte dhe prova që janë të disponueshme.

Për sa i takon pyetjes tjetër se çfarë do të ndryshoja, unë përsëri i qëndroj interpretimit të drejtë të ligjit. Fokusohem shumë te ligji, sepse, nëse do të merrja një rast të thjeshtë, ku në ligj thuhet se procedurat e hapura përdoren në ato raste kur ligji është i përcaktuar dhe duhet të jenë mbi vlerën minimale të procedurave, mbi ofertat minimale dhe në këtë rast mbi 12 milionë lekë për punën apo 5 milionë lekë për shërbimet dhe për mallrat, do të shihni se autoritetet kontraktore përdorin procedurën 5 milionë lekë, kërkesë për propozime. Në këtë rast ajo që unë

do t'ju thosha është se ligji është mëse i qartë, por ajo që pengohet apo ajo që është pengesë, është problem për ne, është leximi i mirë.

Në këtë formë e mendoj!

Ervin Bushati - Faleminderit!

Në fakt, unë e shoh si pozitiv trendin dhe eksperiencën tuaj në bashki duke ardhur nga pushteti lokal, se, me sa kuptoj, ka një tension pas reformës administrative ndërmjet autoritetit kryesor dhe prokurimeve, që bëhen nëpër rrethe. Ky tension patjetër që duhet të jetë i mirë për sa kohë ruan fondet publike, por, kur në të dyja palët bëhet presion për të përfituar secila, nuk është e shëndetshme. Sa do ta mbron ju këtë lloj balance dhe çfarë mund të bëni më shumë? Kam përshtypjen që e njihni këtë pjesë. Komisioni mund t'i imponohet një bashkie të caktuar dhe një bashkie të vogël, i cili shpeshherë ka kthyer edhe vendime. Si do ta mbron ju këtë pavarësi dhe balancë të brishtë që vendoset mes këtyre dy institucioneve?

Faleminderit!

Vilma Zhupaj – Gjatë gjithë kohës ne themi: “Fokusimi gjithmonë te legjislacioni dhe nuk...”

Ervin Bushati -Mendoj që një pikë e fortë në CV-në tuaj është kjo, që ju vini nga një bashki dhe do të mbron bashkitë e tjera në këtë punë. Këto i shtoni ju mozaikut, se problemin e vërtetë unë nuk e shoh tek ata që kanë dhënë vendime, të cilët nuk e kanë njohur shumë mirë, apo ekselent legjislacionin. Ka pasur interesa ekonomike që kanë qenë më të forta se legjislacioni. Të mos bëjmë sikur s'e kuptojmë! Prandaj ne e kemi kthyer tërësisht procesin, që të gjejmë ca njerëz të mirë.

Pra, ju keni këtë pikë të fortë, që vini nga një bashki e vogël që mund të ndikohet , ku KPP-ja vendos t'ia japë të katërtit apo të pestit, që ka dyfishishin e ofertës dhe, duke anashkaluar bashkinë, ti ngre duart. Si do ta mbrosh ti këtë?

Vilma Zhupaj – Në qoftë se institucionet tona, me buxhetet e tyre të vogla mundohen të realizojnë të gjithë ofrimin e shërbimeve që kanë institucionet në të gjithë territorin që operon bashkia, mendoj se do të ishte shumë mirë në këtë rast, e thashë edhe më parë, që vendimet e komisionit të prokurimit të përkthehen në efektivitet fondesh. Shohim shumë herë, të paktën mua nuk më ka ndodhur të më jenë ndryshuar vendimet, por, nëse do të ndodhesha në ato kushte ku do të më besohej detyra, do të isha një ndër personat që do ta mbroja fort shqyrtimin e një çështjeje në rastin e autoriteteve, që do të jenë bashkitë, sepse e di shumë mirë se ç' do të thotë të

operosh me ato fonde, ç'do të thotë diferencë ndërmjet operatorit të parë dhe të dytit, di se çfarë pasojash do të ketë në vazhdimësi procesi apo vendimi që do të marrë Komisioni i Prokurimit Publik. Mendoj se do të jem një ndër personat që do të bëja një arsyetim shumë më të fortë, në rast se do të kishte një gjë të ngjashme.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi -Zonja Zhupaj, ju falënderoj për prezantimin që bëtë!

Më vjen mirë që në fjalën tuaj prekët disa nga rekomandimet që i kemi bërë Komisionit të Prokurimeve Publike, ne si Komision i Ekonomisë, edhe si Kuvend.

Dëshiroja t'ju pyesja specifikisht, duke marrë shkak edhe nga fakti që jeni juriste në profesion, por edhe ju e përmendët unifikimin e vendimeve, mendoni se mund të jeni një vlerë e shtuar në procesin e unifikimit të vendimeve, që ne si Komision i Ekonomisë dhe Kuvend i kemi ngarkuar Komisionit të Prokurimeve Publike?

Vilma Zhupaj – Besoj që po!

Ajo që thashë edhe më parë është që Komisioni i Prokurimit duhet të bëjë unifikim vendimesh, sepse janë modele për vlerësimin, për autoritetetin, cilido qoftë autoriteti kontraktor. Janë modele që përkthehen në efektivitet fondesh dhe në këtë formë, mendoj që do të rregullonte sistemin në tërësinë e tij.

Në qoftë se një dispozitë ligjore duhet të interpretohet në atë formë që ligji është krijuar për t'u interpretuar, Komisioni i Prokurimit Publik, i cili është një nga hallkat kryesore, besoj se do të ndikonte shumë fort për të realizuar këtë proces.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sigurisht!

Erion Braçe - Ka pyetje të tjera?

Zonja Zhupaj, faleminderit për prezantimin!

Jeni e lirë të largoheni!

Të hyjë kandidati tjetër.

Xhevit, s'të kam parë ndonjëherë kaq të gëzuar?! Çfarë ka ndodhur?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të pëlqeu kandidatja?

Lindita Skeja - Përshëndetje të gjithëve!

Erion Braçe – Përshëndetje edhe ju!

Vini para këtij komisioni për shkak të propozimit që ka ardhur në Kuvend nga Këshilli i Ministrave për të qenë kandidate e mundshme për detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik. Do të donim një prezantim tuajin. CV-në tuaj të gjithë kolegët e kanë para. Do të donim një ide tuajën për prokurimin publik dhe, natyrisht, një ide tuajën për Komisionin e Prokurimit Publik.

Lindita Skeja -I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Kam nderin të më lejoni t'ju falënderoj për mundësinë dhe vëmendjen tuaj për prezantimin e punës sime në fushën e prokurimeve publike, si dhe eksperiencën time në këtë fushë.

Quhem Lindita Skeja. Jam diplomuar pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 1996 dhe aktualisht punoj në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare sh.a, në pozicionin përgjegjëse e sektorit të prokurimeve publike.

Fillimet e karrierës sime si juriste i kam në qeverisjen vendore dhe konkretisht kam punuar pranë komunës së Librazhdit nga viti 1996 e deri në vitin 2015. Gjatë kësaj periudhe kam mbajtur pozicionin përgjegjëse e sektorit juridik, ku krahas çështjeve të ndryshme ligjore, kam përfaqësuar institucionin në të tria shkallët e gjyqësorit, kam ndjekur problematika të ndryshme ligjore dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik. Në këtë detyrë kam qenë kryetare e njësies së prokurimit publik dhe procedurave të prokurimit me blerje të vogël.

Deri në vitin 2006 kam zbatuar ligjin nr. 7971, datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik”, aktualisht i shfuqizuar. Në periudhën 2007-2011 kam mbajtur detyrën e drejtoreshës së Marrëdhënieve me Publikun. Edhe në këtë pozicion, krahas detyrave të tjera, kam qenë përsëri kryetare e njësies së prokurimit publik dhe anëtare e komisioni për blerje me vlera të vogla.

Në janar të vitit 2007 hyri në fuqi ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”. Ky ligj kishte ndryshime drastike dhe për herë të parë në vitin 2009 në administratën publike dhe në të gjitha institucionet shtetërore, u aplikua procedura e prokurimit me mjete elektronike.

Në periudhën 2011-2015 kam mbajtur detyrën përgjegjëse e sektorit juridik ku edhe këtu kam qenë kryetare e njësies së prokurimit publik dhe anëtare e komisionit të procedurës së prokurimit për blerje me vlera të vogla.

Në vitin 2015, me ndarjen territoriale që iu bë pushtetit vendor, jam sistemuar në Bashkinë e Librazhdit me detyrën përgjegjëse e sektorit juridik. Edhe në këtë pozicion, krahas detyrave ligjore, kam qenë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, kryetare e komisionit për blerjet me vlerë të vogël dhe në disa raste kryetare e shqyrtimit të ankesave për kriteret e dokumenteve të tenderit.

Në nëntor të vitit 2016 e në vazhdimësi jam punonjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare sh.a, në pozicionin përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve Publike.

Krahas arsimimit që kam në fushën e drejtësisë, në vitin 2004 kam fituar titulli “Avokat”. Në vitin 2010 kam marrë titullin “Master i nivelit të dytë në Shkencat Administrative”, pranë Universitetit “UFO”.

Gjatë kësaj kohe kam punuar edhe si juriste me kohë të pjesshme pranë drejtorisë spitalore, drejtorisë së Shërbimit Shëndetësor, ish-drejtorisë Pyjore, Librazhd. Gjithashtu, në periudhën 2011-2013 kam qenë anëtare e Këshillit Mbikëqyrës pranë Drejtorisë së Ujësjiellës-Kanalizime, Librazhd.

Duke qenë se në detyrat e mia kam qenë juriste prokurimesh për një periudhë më shumë se 20-vjeçare dhe e njoh mirë të gjithë historikun e ligjit të prokurimit, që prej vitit 1995 kur është krijuar dhe në vijim, mendoj se është një anë e fortë imja, që më bën të kandidoj për këtë pozicion.

Në lidhje me komisionin, duke u futur në pjesën e institucionit të prokurimeve, mendoj se do të ishte me vend në vizionin tim që disa drejtime të riparohen, kryesisht vendimet unifikuese të Komisionit të Prokurimeve.

Duke qenë se Komisioni i Prokurimeve funksionon si kuazi gjykatë dhe jo si gjykatë, vendimet e saj duhet të jenë në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit dhe duhet të përkthehen në legjislacion. Kjo do të sillte uljen e ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik, e cila ka një kosto për të gjithë shoqëritë tregtare që ankohen. Dihet që çdo ankesë bëhet në bazë të një kuote të caktuar financiare në lidhje me vlerën e fondit limit që prokurohet.

Pjesa tjetër mendoj se është shpejtësia e shqyrtimit të ankesave dhe në dhënien e vendimmarrjes në Komisionin e Prokurimit Publik. Kjo është një problematikë, e cila jo pak herë u shkakton probleme autoriteteve kontraktore. Duke qenë se ka një buxhet vjetor dhe brenda këtij viti duhet ta realizojnë, në të mirë të realizimit të projekteve dhe investimeve për planin e buxhetit që ka parashikuar për këtë institucion, vendimmarrja sa më e shpejtë do të ishte shumë

produktive dhe për secilin autoritet kontraktor, po ashtu edhe për nevojat që kanë autoritetet kontraktore për mall, shërbim, apo punë.

Vizioni im është: integriteti, paanshmëria, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë në garat konkurruese, pavarësia, efektiviteti, efienca dhe nxjerrja e vendimeve në një kohë reale, sepse djegia e fondeve publike shkakton shumë probleme. Mosdiegia e këtyre fondeve bëhet duke dhënë vendime në kohë dhe sa më shpejt.

Po kështu, vizioni im është të siguroj mirëpërdorimin e fondeve publike dhe të ul shpenzimet procedurale; të nxis pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë; të sigurojë integritet, besim në publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonjë!

Ka pyetje?

Zoti Xhakolli, keni pyetje? Nuk keni.

Zoti Bushati, urdhëroni!

Ervin Bushati – Faleminderit për prezencën!

E shikoj me vlerë eksperiencën tuaj, që keni marrë pjesë në prokurime, jeni marrë me ligjin dhe me njësitë lokale. Mendoni se do t'i mbronin interesat e bashkive? Gjithmonë ndodh që bashkive u kthehen tenderët nga Komisioni i Prokurimeve Publike. Sido që të jetë, e vërteta nuk mund të jetë as në njërin krah, as në tjetrin, është diku në mes, por në të gjitha rastet ose janë dhënë në vlera të plota, ose është rikthyer me vlerë pranë Komisionit të Prokurimeve Publike. Si do ta mbani ju këtë balancë? Cila do të jetë vlera juaj e shtuar në këtë komision?

Faleminderit!

Lindita Skeja – Vlera ime në Komisionin e Prokurimit Publik do të jetë ligji dhe vetëm ligji në zbatim dhe në respektim të tij. Aktualisht dhe realisht në eksperiencën e punës sime kam zbatuar ligjin me përpikëri dhe paanshëmi.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Në CV-në tuaj shikoj që keni qenë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Në sa vendime ka qëndruar në fuqi vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kur operatorët e

ndryshëm kanë bërë ankesë kundër entit prokurues për vendim të padrejtë dhe vendimet nga KPP-ja ju janë kthyer juve mbrapsht?

Lindita Skeja – Konkretisht, për vitin 2017 kam vlerësuar pothuajse 6 procedura, të cilat janë ankimuar në Komisionin e Prokurimit Publik, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Konkretisht, ka qenë pulla, blerja, prodhimi i pullës në Postën Shqiptare, ka qenë sistemi i kamerave, vëzhgimi DNV 8, 12 dhe 16 dhe kancelaritë.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Zonja Skeja, shumë faleminderit për prezantimin tuaj!

Jeni e lirë të largoheni.

Të vijë kandidati tjetër.

Lindita Skeja – Faleminderit!

Punë të mbarë!

Erion Braçe – Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Zanaj, ju keni qenë edhe një herë tjetër këtu, kështu që e njihni procedurën.

Do të procedojmë me një prezantim të shkurtër tuajin, sepse e kemi CV-në, por më tepër me një ide tuajën për Komisionin e Prokurimit Publik nën tagrin e propozimit për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik, një ide tuajën edhe për vet komisionin.

Më pas, në rast se ndonjë nga kolegët ka pyetje, do të jeni i lutur të jepni disa përgjigje.

Julian Zanaj – Përshëndetje, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

E kam filluar karrierën time në vitin 2001 pranë Bashkisë së Tiranës, ku kam vazhduar deri në vitin 2011. Kam punuar specialist, përgjegjës sektori dhe më pas kam qenë drejtor pranë Drejtorisë së Prokurimeve. Më vonë kam punuar pranë shoqërisë për menaxhim të përkohshëm CEZ sh.a, më vonë OSHEE. Nga viti 2016 e në vazhdim punoj në pozicionin e drejtorit në Drejtorinë e Prokurimeve pranë Bashkisë së Tiranës.

Gjatë karrierës sime kam pasur rastin të punoj me të gjitha procedurat, si blerje mallrash dhe shërbimesh, me të gjitha tipet e legjislacionit të periudhës nga viti 2001 e në vazhdim, duke konstatuar si të mirat, të këqijat e legjislacionit dhe dobësitë që mund të ketë edhe në vazhdimësi, gjë që më ka dhënë eksperiencën e duhur për punën në prokurime dhe në gjykimin gjatë procedurave të prokurimit. Gjatë procedurave të prokurimit kam punuar në të gjitha llojet e

pozicioneve, si njësi e prokurimit, në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave duke e kompletuar të gjithë ciklin e një procesi prokurimi brenda një institucioni.

Këto janë arsyt që më shtynë të kandidoj për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik. Pra, eksperiencia e fituar për procedurën, si dhe gjykimi i bazuar mbi këtë eksperiencë, do të jetë një kontribut pranë këtij komisioni.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Zana!

Ka pyetje?

Zoti Bushati, keni pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit!

Kolegët e tjerë kanë pyetje?

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Zoti Zana, faleminderit për prezencën tuaj dhe për shpjegimet që dhatë!

Unë do të doja t'ju pyesja se cila mund të jetë arsyeja që ju shtyn të lini vendin që keni sot për të konkurruar si anëtar në Komisionin e Prokurimeve Publike?

Julian Zana – Sikurse e thashë, ndoshta fati, por edhe jeta, bëri që unë të marr karrierën e prokurimeve, duke filluar nga specialist, përgjegjës sektori dhe drejtor. Maja e prokurimeve është Komisioni i Prokurimit Publik. Pra, një njeri, gjatë gjithë karrierës do ta kërkojë këtë, falë eksperiencës, por edhe falë kontributit që ka dhënë për prokurimet. Ajo është pika më e lartë e prokurimit brenda Republikës së Shqipërisë.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Jeni i lirë.

Julian Zana – Faleminderit, zoti kryetar!

Erion Braçe – Të vijë kandidati tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Deri tek i 12-i. Domethënë kemi edhe 5.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e kam unë fajin që ti zihesh me Edmond Spahon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka ikur ministrja?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumë mirë.

Zonja Veizaj, shumë faleminderit për prezencën tuaj këtu!

Jeni para këtij komisioni në funksion të një seance dëgjimore që ne e kemi detyrim ligjor ta zhvillojmë me të gjithë kandidatët e propozuar nga Këshilli i Ministrave për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Do të procedojmë me një prezantim tuajin të shkurtër. CV-në tuaj personale dhe profesionale e kemi përpara, por do të donim një ide më shumë nga ju për prokurimin publik në tërësi dhe veçanërisht për Agjencinë e Prokurimit Publik si e mendoni ju.

Më pas kolegët janë të lirë të adresojnë pyetje kundrejt jush dhe ju jeni i detyruar të jepni disa përgjigje për interesin e tyre.

Keni fjalën.

Ravena Nuri Veizaj – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Quhem Rovenë Veizaj. Kam mbaruar Universitetin e Tiranës, Fakultetin Juridik në vitin 2001. Në vitin 2002 kam punuar për një periudhë të shkurtër në Drejtorinë e Tatim-Taksave të rrethit të Fierit dhe më pas, nga viti 2003 deri në vitin 2006 kam punuar si juriste pranë Bashkisë së Fierit dhe si përgjegjëse e sektorit Juridik.

Në fund të vitit 2006 jam punësuar në një subjekt privat dhe kam punuar atje deri në shtator të këtij viti. Nga nëntori i vitit 2006 deri në nëntor të vitit 2015 kam punuar juriste, specialiste në sektorin juridik pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, ish-projekti 2KR.

Nga nëntori i vitit 2015 deri në prill të vitit 2016 kam punuar si avokate e Shtetit pranë Ministrisë së Drejtësisë, duke mbuluar Ministrinë e Kulturës, Agjencinë e Trajtimin të Pronave.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural kaloi me status të nëpunësit civil me ndryshimet që solli ligji dhe konkurrova sërish aty duke zënë vendin e përgjegjëses së sektorit Juridik, ku jam aktualisht.

Jam e kualifikuar si avokate, si ndërmjetëse dhe si inspektore financiare. Kam marrë pjesë në dy inspektime të rëndësishme të Portit Detar të Durrësit dhe të një pjese të prokurimeve të Drejtorisë së Rrugëve.

Kjo është shkurtimisht eksperiencia ime.

Një nga arsyet që më ka shtyrë të marr pjesë si anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik është përkushtimi im ndaj këtij ligji dhe pjesëmarrja në vazhdimësi në procedurat e prokurimit publik, duke filluar nga viti 2003, sikurse ua parashtrova më parë, ka qenë pjesë e ligjit të vjetër dhe aktualisht.

E njoh ligjin e prokurimit publik, jam e përkushtuar ndaj këtij procesi dhe mendoj se kam dhënë maksimumin tim në drejtimin e institucionit, që të ketë procedurat më të mira.

Ky ishte prezantimi im i shkurtër.

Erion Braçe – Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët?

Zonja Veizaj, kam unë një pyetje.

Ju thatë se keni punuar pranë projektit 2KR, apo jo?

Rovena Nuri Veizaj – Po.

Erion Braçe – Ai projekt është audituar në vijimësi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit deri në momentin që u mbyll, ashtu si nga qeveria japoneze, në mos gabo.

Rovena Nuri Veizaj – Po, e saktë.

Erion Braçe – Janë pretenduar shkelje të mëdha të kryera apo të konsumuara nga ai projekt. Cili është mendimi juaj, qoftë për mënyrën si ka funksionuar ai projekt, qoftë edhe për pretendimet në raport pikërisht me funksionimin e projektit, edhe nga pikëpamja e efektivitetit të parasë shqiptare ndërkombëtare të hedhur aty, edhe nga pikëpamja e ligjshmërisë së zbatuar ose jo gjatë ushtrimit financiar të projektit?

Rovena Nuri Veizaj – E vërtetë është që auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka lënë disa detyra shumë të rëndësishme për projektin 2KR, që sot është përfshirë në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe, gjithashtu, ka pasur disa probleme me mirëmenaxhimin e fondeve, kryesisht ato të granteve japoneze, ku dua të cilësoj lidhjen e kontratave me to. Duke marrë shkas nga raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit, aktualisht Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është duke ndjekur rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit edhe pse në avancë të

kohës. Bëhet fjalë për lidhjen e shumë kontratave me grantin japonez dhe mbledhjen apo menaxhimin e fondeve të subjekteve që vazhdojnë të jetë aktualisht debitore ndaj shtetit shqiptar.

Në gjykimin tim, mirëmenaxhimi i fondeve nga projekti japonez ka pasur disa problematika, që mendoj se janë duke shkuar drejt rrugës së duhur me krijimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.

Erion Braçe – Së dyti, ju thatë se keni punuar pranë Avokaturës së Shtetit apo jo?

Rovena Nuri Veizaj – Po, kam punuar pranë Avokaturës së Shtetit. Kam mbuluar Ministrinë e Kulturës dhe disa institucione të tjera.

Erion Braçe – Mund të më thoni një çështje për të cilën jeni investuar dhe ka pasur lidhje me Ministrinë e Kulturës?

Rovena Nuri Veizaj – Po.

Kam ndjekur një çështje, por jo deri në përfundimin e saj, sepse u largova. Ka qenë rasti i një kontrate qiraje e lidhur me një subjekt privat brenda mjediseve të Teatrit të Operës dhe Baletit. Kjo kontratë sponsorizimi e lidhur midis një subjekti privat i Ministrisë së Kulturës kishte një afat 5-vjeçar. Në momentin kur unë jam investuar si Avokate e Shtetit, kjo kontratë ishte në mbarim të këtij afati 5-vjeçar. Më pas, me një udhëzim të brendshëm të Ministrisë së Kulturës, kjo kontratë duhej të kalonte në disa procedura për rikualifikimin e saj. Subjekti i cili vazhdonte ta kishte këtë kontratë qiraje, nuk e kishte fituar fazën e parë të kualifikimit, megjithatë rilidhëm kontratën e qirasë dhe me ripërtëritjen e asaj, kjo palë shkoj në gjykatë dhe investoi si Ministrinë e Kulturës, si Teatrin e Operës dhe Baletit dhe vetë palën.

Më pas jam interesuar për procesin dhe di që Ministria e Kulturës ka zgjidhur kontratën me subjektin sponsorizues dhe aktualisht subjekti sponsorizues nuk e ushtron më aktivitetin e tij. Ky është një rast që unë e kam ndjekur, jo në përfundim, por jam interesuar për të.

Erion Braçe – Faleminderit!

A keni pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Veizaj, për prezencën dhe prezantimin tuaj!

Rovena Veizaj – Faleminderit!

Erion Braçe – Mirëdita, zonja Xoxa!

Ndodheni para këtij komisioni për të bërë një prezantim tuajin jo thjesht dhe vetëm personal, por edhe në raport me idenë tuaj lidhur me prokurimet publike në këtë vend, por edhe me funksionin e agjencisë apo Komisionit të Prokurimit Publik, funksion për të cilin ju jeni

propozuar nga Këshilli i Ministrave. Kështu që do të fillojmë me prezantimin tuaj dhe më pas nëse kolegët deputetë kanë pyetje lidhur me interesa të ndryshme që lidhen me prezantimin tuaj, pa asnjë lloj diskutimi, jeni të lutur të na jepni edhe disa përgjigje.

Urdhëroni!

Nevila Xoxa – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë dhe anëtare të komisionit,

Unë jam Nevila Xoxa dhe ju falënderoj që më dhatë mundësinë për t'u shprehur për aplikimin tim në pozicionin e anëtares pranë Komisionit të Prokurimit Publik!

Shkurtimisht, do të fokusohem në disa pika kryesore lidhur me edukimin dhe formimin tim, përvojat profesionale që unë kam pasur dhe pikat gjatë rrugës sime profesionale me prokurimet publike, pika që unë mendoj si avantazhe dhe që më kanë shtyrë për të kandiduar për këtë pozicion.

Po jap disa vlerësime të përgjithshme për disa risqe lidhur me prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë modeste, një vizion timin rreth aktivitetit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Kam ndjekur studimet në degën Informatikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe në vitin 2002 kam fituar titullin “Informaticiene”. Në vitin 2011 kam fituar gradën “Master shkencor” në ekonomi në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës. Aktualisht, pasi kam mbrojtur doktoraturën në degën Informatikë, përsëri në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, po punoj për mbrojtjen e tezës në fushën e menaxhimit të informacionit dhe të njohurive në integrimin i këtyre sistemeve në qendrat kërkimore dhe shkencore.

Lidhur me përvojat profesionale, prej vitit 2008 menaxhoj Shërbimin e Teknologjisë së Informacionit në Akademinë e Shkencave. Në Akademinë e Shkencave u punësova pas një përvoje 4-vjeçare, përkatësisht vitet 2002-2006 si kërkuese shkencore në Institutin e Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar INIMA. Në sektorin privat kam punuar rreth 5 vjet, përkatësisht vitet 2002-2005 me kohë të pjesshme dhe vitet 2006-2008 me kohë të plotë, si përgjegjëse për zhvillimin e aplikacioneve dhe drejtuese e prokurimeve të shërbimeve që këto kompani ofronin.

Gjatë 16 vjetëve të fundit, përkatësisht prej vitit 2002, kam dhënë dhe vazhdoj të jap leksione si pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës, në Universitetin Politeknik dhe në universitetin “New York” të Tiranës.

Po ju jap disa nga arsyet që më kanë shtyrë për të aplikuar në këtë pozicion. Për t'i shërbyer sa më shumë publikut, si anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik, do të ndihmojnë cilësitë dhe përvojat e mia të deritanishme. Përvoja në të dy sektorët publikë dhe privatë vlerësoj se është një avantazh.

Pozicioni i anëtares së Komisionit të Prokurimit Publik është një pozicion që kërkon një sinergji të eksperiencave në të dy sektorët. Nga përvoja në sektorin privat kam kuptuar përpjekjet që bëjnë ofertuesit, qoftë edhe brenda hapësirave ligjore, për të maksimizuar dhe marketuar kredencialet dhe fuqinë e tyre në treg. Ofertuesi synon të maksimizojnë shanset që të fitojnë dhe ofrojnë shërbime me kosto të ulët. Ndërkohë nga përvoja në sektorin publik, kam mësuar dhe synuar që interesi publik realizohet sipas filozofisë: “Të përfitojmë shërbime cilësore duke harxhuar sa më pak para publike”.

Përvoja si inxhinieri informatike më ka ndihmuar për të konsoliduar aftësitë analitike për menaxhuar flukset e informacioneve, si dhe për të bërë vlerësim dhe për të marrë vendime racionale dhe pa emocione. Përvoja e gjatë akademike më ka pajisur me durimin dhe shprehitë për të kontrolluar dhe vëzhguar në detaje dokumentet shkresore dhe gjithashtu të jem e drejtë kur të marr vendimet.

Fakti që procedurat e aplikimit janë tërësisht elektronike, përveç integritetit moral, ligjor dhe institucional, kërkon edhe një përgatitje specifike profesionale. Si punonjëse publike dhe pjesëtare e shërbimit civil, ndjek me vëmendje zhvillimet dhe reformat që po zbaton qeveria, sidomos luftën kundër informalitetit, përmirësimin e klimës dhe thjeshtimin e procedurave të të bërit biznes, transparencën e shërbimeve publike, procesin inovativ të bashkëqeverisjes me qytetarët dhe dixhitalizimin e procedurave shërbimeve të ndryshme. Të gjitha këto procese kanë mjaft pika takimi me prokurimin publik dhe eficientia, integriteti transparenca e prokurimit publik është një faktor kyç për performancën e qeverisjes.

Në punën time jam udhëhequr nga standardi se ligjet janë vetëm për t'u zbatuar dhe nuk ka alternativë tjetër. Gjatë 10 vjetëve të fundit kam kryesuar ose marrë pjesë në komisione të prokurime publike të administratës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Këto procedura gjatë të gjithë harkut kohor kur unë kam marrë pjesë, janë kryer në ligjshmëri të plotë dhe me performancë të lartë. Ndërkohë, gjatë përvojës sime në sektorin privat, kam marrë pjesë ose kam drejtuar grupe pune për përgatitjen e aplikimeve, për pjesëmarrjen në gara të shpallura nga

Agjencia e Prokurimit Publik, si dhe në zbatimin e kontratave të fituara, sipas afateve dhe specifikimeve të kërkuara.

Disa reflektime personale mbi risqet në prokurimin publik.

Gjatë përgatitjeve paraprake për këtë aplikim jam përpjekur të bëjë një vlerësim personal mbi risqet e mundshme të zbatimit të procedurave të prokurimit publik në Shqipëri. Unë e kam të qartë se anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik kanë për detyrë të zbatojnë pa ekuivok legjislacionin përkatës dhe jo të bëjnë vlerësimin apo vlerësuesin e sistemit. Megjithatë, dua të nënvizoj disa risqe, parandalimi i të cilave mund të shërbejë për përmirësimin e performancës dhe forcimin e integritetit të sistemit. Sipas mendimit tim, mund të ndodhë që disa kompani të reja, të sapo hyra në treg, të fitojnë disa kontrata publike rresht dhe në një kohë shumë të shkurtër, krahasuar me një kohë normale që mund të ketë një kompani. Në këto raste procedurat e prokurimit mund të jenë në rregull nga ana ligjore, por integriteti i procesit ka edhe një përmasë tjetër morale. Kjo përmasë morale mund të sjellë dy pasoja: të ndikojë në perceptimin publik, duke paragjykuar kështu procesin, dhe të dëmtojë në një rast pasardhës ligjshmërinë e procesit. Mund të ndodhë, në rrethana të caktuara, që të ofrohen një numër jo i pranueshëm kontratash publike me një konkurrues të vetëm ose pa e publikuar tenderin. Këto procedura mund të ndodhin për shkaqe të arsyeshme dhe të justifikuara ligjërisht, por kur kalohen normat e pranuar ligjërisht dhe moralisht, ky risk mund të sjellë pasoja të ndryshme. Pra, dëmton integritetin e procesit, ul eficiencën e shërbimeve dhe nuk pajtohet as me standardet e BE-së, të cilat rekomandojnë një përqindje të caktuar, që në dijeninë time është nën 5%. Duhet të tregohet kujdes jo vetëm për sasinë numerike, por për vlerën e tyre financiare, të cilat mund të jenë asimetrike me numrin e këtyre kontratave të lidhura.

Një risk tjetër për sistemin është konkurrimi i disa kompanive, në marrëveshje dhe për të mbështetur njëra-tjetrën. Në këtë rast mund të ndodhë që fituesi i garave dhe kontratave publike të përcaktohet jo nga ligji, procedurat, kapacitetet ekonomike dhe konkurrenca e ndershme, por nga marrëveshja midis kompanive konkurruese. Pra, korruptimi i procedurave dhe procesi ndodhin jo për shkak të sistemit, por për shkak të tenderuesve privatë. Duke u nisur dhe nga përvojat e mia direkte në procesin e prokurimeve dhe si përgatitëse ofertash, por edhe si anëtarë dhe drejtues të komisionit, duhet të shmanget risku që kompanitë konkurrense të paraqesin oferta me çmime mjaft të ulëta disa herë edhe nën kosto, me shpresën se do të rinegociojnë çmimin para nënshkrimit të kontratës. Kjo mund të ndodhë në rastet kur ofertuesit mund të ripërdorin

infrastrukturën nga shërbime të mëparshme. Mjaft kompani konkurruese mund të regjistrohen dhe garojnë për kontrata publike, si prodhues ose ofrues, me një shumëllojshmëri mallrash dhe shërbimesh, përcaktuar kjo në objektin e tyre si shoqëri tregtare. Kjo sjell që për kontrata publike specifike të garojnë dhe konkurrentë jo të specializuar, të cilët mund të shpallen fitues për shkak të kostove të ulëta që ata ofrojnë, si rrjedhojë mund të ndodhë që këta ofertues të mos plotësojnë kriteret lidhur me cilësinë e produkteve apo shërbimeve deri edhe në dështim, në plotësimin e termave të kontratës, dhe për rrjedhojë të komprometojnë ose të falimentojnë të gjithë procesin. Ndodh që sistemi dhe procedurat e prokurimit publik, mund të perceptohen si të korruptuara prej publikut, qytetarëve apo medias. Ky perceptim për sistemin shkakton demotivimin e kompanive private, sidomos tek investitorët e huaj për të konkurruar për kontrata publike për shkak të perceptimit të gabuar se fituesit janë të paracaktuar.

Në lidhje me vizionin që kam për Komisionin e Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik nuk është një institucion politikbërës, megjithatë mendoj se ka vend që në funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik mund të bëhen disa ndryshime, të cilat rrisin integritetin dhe përgjegjësinë e këtij komisioni para ligjit dhe para publikut. Komisioni mund të ndër marrë edhe vetë shqyrtim procedurash prokurimi pa pasur ankesë nga ofertuesit. Kjo mund të ndodhë në rastet kur ka indicie të besueshme nga institucione, media apo qytetar për parregullsi apo favorizime të dukshme dhe të rënda gjatë procedurave të prokurimit, të cilat dyshohet se dëmtojnë rëndë buxhetin e shtetit dhe integritetin e procesit të prokurimit publik. Mendoj se ky propozim bën sens në kontekstin e filozofisë së bashkëqeverisjes me qytetarët.

Mbledhjet e KPP-së mund të jenë të hapura për mediet, ato mund të zhvillohen të mbyllura vetëm në rastet kur informacionet që trajtohen përfshirë aspektet teknike, sekretet tregtare informacionet preferenciale të ofertave apo lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare.

Së fundi, në rast se ka konkurrentëve nga diaspora, për pjesëtarë të Komisionit Prokurimit Publik, gjykoj se vjetërsia në punë edhe përvoja në prokurime mund të kufizohet. Sipas nenit 19 pika 3, ku përcaktohen dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët për të qenë pjesë e Komisionit të Prokurimit Publik nevojiten të paktën 8 vjet përvojë pune, nga të cilat të paktën 3 në fushën e prokurimeve. Unë mendoj se profesionistë nga diaspora, të diplomuar në universitete prestigjioze ose që kanë punuar qoftë edhe pak vite në institucione të rëndësishme ndërkombëtare apo në kompani të njohura për prokurime ose auditimi, mund të ftohen të

aplikojnë për anëtarë të këtij komisioni edhe në rast se vjetërsia në punë dhe përvoja në prokurime nuk është e akorduar nga ligji.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Xoxa, për prezantimin tuaj!

A keni pyetje?

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit për prezencën dhe për prezantimin!

Ne e kemi përsëritur këtë proces, pikërisht për shkak të rëndësisë që ka pasur dhe që ka. Mendoj se kemi bërë shumë mirë që e kemi bërë këtë proces dhe mua më duket shumë interesante që ne po shohim një mozaik të CV-ja juaj me një *background* IT-je shumë të pëlqyeshëm. E para, me sa shoh, keni që nga viti 2008 që jeni në Akademi.

Nevila Xoxa – Po, pranë Akademisë së Shkencave.

Ervin Bushati – Ndërkohë që keni dhënë shumë leksione dhe jepni...

Nevila Xoxa – Po, që prej viti 2002.

Ervin Bushati – Kam një pyetje të shkurtër: a do të keni kohë të merreni edhe më këtë gjë, edhe me atë, sepse shoh që jepni mësim në tri universitete? Pra, kjo kërkon një ngarkesë.

Në fakt, edhe kryetari kërkoi që të regjistroheshin më parë takimet. Unë do të isha edhe me mendimin që të jepeshin *live streaming* në internet. A keni bërë ndonjë studim, duke parë edhe tregun ndërkombëtar, duke u bazuar mbi algoritme apo mbi studime më të sakta matematike se si shkojnë këto? Ne kemi një problem me tenderimet dhe e pranojmë këtë. Pra, themi se me studime të sakta matematike mund të shikohet se ku janë devijimet, se ku janë pësuar golat. Çfarë procedurash mund të kopjojmë nga vende që kanë avancuar në këtë pikë, të cilat nëpërmjet IT-së dhe ndryshimeve kanë sjellë metoda që i kontrollojnë këto abuzime? Mund t'i marrim nga Danimarka, Islanda apo nga Norvegjia, të cilat nuk kanë vetëm *e-government* si koncept kryesor, por që kërkojnë t'i gjejnë këto problematika nëpërmjet modeleve kompjuterike. Si mund të aplikohen këto në Shqipëri? Të paktën në këndvështrimin tim, kjo është pika juaj e fortë që nuk do të donim ta humbnim në këtë skuadër. Të thuash do të zbatoj ligjin, këtë gjë e kanë thënë të gjithë këtu para nesh. Pika e fortë është kjo: a mund të keni ju një program tërësisht që të dilni me matematikë dhe të shikoni se ku kanë ndodhur këto fenomene dhe çfarë mund të bëhet që të mos ndodhin më, qoftë me një transmetim *live (streaming-un)* le ta marrë kush të dojë për çdo çështje që të shihet devijimi standard, pra sa ka lëvizur nga ana matematike. Në

qoftë se në një vend shkohet me 99,7% të vlerës limit, atëherë nuk ka pasur tender. Pra, ka armë teknologjike dhe matematike se si mund të shikohet. Për këto mund të na flisni, se do të donim t'ju dëgjonim me shumë interes.

Faleminderit!

Nevila Xoxa – Lidhur me impenjimin tim në fushën akademike, do të isha e privilegjuar nëse do të zgjidhesha anëtare e këtij Komisioni. Impenjimi im në këtë fushë do të jetë për aq sa më cakton ligji.

Lidhur me studimin, po flisnit për një studim personal apo në kuadër të institucionit kërkimor?

Ervin Bushati – Keni të paktën një muaj që jeni përgatitur për këtë intervistë. Nuk e di kur keni aplikuar. A keni bërë ndonjë kërkim, ndonjë *brainstorming*, *research*, sepse shoh që jeni tip metodik? Qëkur keni marrë sfidën për të kandiduar, a keni parë se çfarë ndodh në botë, të paktën, në botën këtej, të mos flasim për rastet e Rusisë, të Kinës apo të Tunizisë, por për ato që e luftojnë këtë fenomen?

Faleminderit!

Nevila Xoxa – Nuk kam pasur studim konkret, veçse kam bërë një kërkim personal se çfarë ndodh me prokurimin publik në Shqipëri dhe shumë pak shembuj në botë, sidomos në fushën e PPP-ve. Ajo që vija re në vendet aziatike ishte shpërndarja e riskut. Risku mbahej vetëm nga qeveria, por kishte një shpërndarje edhe te partneritet private. Një element tjetër interesant është votimi dhe kalimi në parlament. Domethënë, përcaktimi i fituesve të koncesioneve në vende, si Danimarka që përmendët, vendimmarrjet nuk bëheshin nga institucioni, por kalonin në parlament.

Lidhur me prokurimet publike, me aq sa kam parë, vendet europiane janë munduar të shmangin të gjitha procedurat, të cilat janë me negocim, qofshin me shpallje apo pa shpallje, duke mundësuar vetëm ato raste kur nuk veprohej dot ndryshe, si rasti i të drejtave të autorit apo i të drejtave ekskluzive. Ndërsa në raste të tjera, kur të ketë shërbime shtesë, është kërkuar të bëhej një planifikim më i plotë dhe i më qartë, duke parë edhe nevojat e institucionit të caktuar që të mos të ketë shërbime të tjera në vazhdim dhe të ketë kujdes në momentin e përpilimit të dokumenteve standarde të tenderit në momentin e kërkesave teknike dhe profesionale, pasi një pjesë e mirë e tenderëve në vendin tonë, që na çojnë pastaj në prokurim me negocim, dështojnë

për shkak të mospërputhjes së specifikimeve. Mendoj se këto janë disa nga elementet që mund t'i zbatohet në vendin tonë.

Lidhur me sistemin, çdo sistem informatik është gjithmonë në përputhje me disa kërkesa. Kjo do të thotë se, sado i mirë të jetë një sistem, nuk është i përsosur dhe ka vend për t'u rregulluar. Sistemet që duhet të ndërtohen në raste të tilla duhet të ishin në përputhje të plotë me ligjin e vendit ku ai zbatohet. Nëse flasim për risqet e sistemit dhe flasim më tej pastaj për risqet e kibernetikës, kjo është një fushë e cila është shumë komplekse, mund të minimizohet, por nuk mund të parandalohet. Sulme të tilla mund të dedektohen, pastaj të dënohen me ligj.

Erion Braçe – Po, urdhëroni!

Ervin Bushati – Problemi që ne kemi është se në të gjitha intervistat këtu, kur diskutohet dhe kur flasin në parim, kërkohet një perfeksion gati 100%. Nuk është puna te kjo, por që të ketë një lloj alogjikë ekonomike ose teknologjike në këtë ekip dhe duhet të ketë një integritet moral, sepse nuk na cedojnë gjërat për 2%-3% humbje në sistem. Nuk flasim për entropi të vogël, por për cedime të mëdha. 80% e tenderëve që diskutohen dhe që vijnë te KPP-ja, në qoftë se e dini, vinin vetëm nga kompanitë e rojeve private. Pyeta për këtë gjë, por nuk ma shpjegonte dot njeri. Nuk e di nëse mund ta çlirojmë këtë lloj fluksi. Fakti që disa tenderë, kur janë të mëdhenj, shkojnë 9,7 dhe tenderët e vegjël janë gjithmonë në 60% të vlerës limit, kjo më bën mua të dyshoj për gjëra të mëdha dhe këtu duhet pastaj integriteti moral. Nuk ishte pyetje kjo.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Atëherë, shumë faleminderit!

Nevila Xoxa – Ju falënderoj! Punë të mbarë!

Erion Braçe – Faleminderit!

Vazhdojmë me kandidaturën tjetër.

Blerina Gjylameti – Përshëndetje, zonja Shkurti!

Në CV-në tuaj e kemi përpara. Ju lutem shumë shkurt diçka më shumë përtej CV-së lidhur me arsyet përse keni aplikuar për të qenë pjesë e Komisionit të Prokurimit Publik.

Faleminderit!

Miranda Shkurti – Atëherë, meqenëse duhet të flas shkurt, do të them thjesht se janë bërë më shumë se 10 vjet që punoj me prokurimet. Punoj në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Kjo

është një fushë të cilën e njoh. Në momentin e parë kur pashë njoftimin për anëtare të KPP-së, po nguroja dhe thashë se ndoshta nuk është për mua ky vend, pastaj thashë përse të mos e provoj njëherë, duke menduar që ligjin e njoh, ka kaq vite që punoj në këtë fushë. Jam një njeri që punoj me korrektësi(më falni, se kam edhe pak emocione) dhe me përkushtim në punë. Kështu që thashë: pse të mos shkoj të konkurroj edhe unë?! Dhe ja ku jam tani këtu. E njoh goxha mirë ligjin e prokurimit, njoh vendimet e KPP-së që merren herë pas herë. Fatkeqësisht, procedura tona shkojnë në KPP, sepse janë procedura me vlera shumë të mëdha, operatorët janë të fuqishëm dhe, dashur pa dashur, kanë konkurrencë dhe shkojnë përplasen në KPP me ankimet e tyre. Mendoj se kam njohuritë dhe aftësitë e duhura për të qenë anëtare e KPP-së.

Blerina Gjylameti – Ndonjë element tjetër që do të donit ta prezantonit përpara anëtarëve të komisionit, pra përtej pjesës që i keni aftësitë dhe njohuritë e duhura.

Miranda Shkurti – Domethënë, janë përkushtim im në punë, aftësitë, njohja e bazës ligjore, arsimimi, sepse kam dy fakultete, Juridikun dhe Ekonomikun dhe kam më shumë se 20 vjet që punoj në administratën civile. E kam filluar punën në Prokurorinë e Tiranës, pastaj në Ministrinë e Punëve Publike, më pas kam kaluar tek Autoriteti Rrugor Shqiptar. Mendoj se gjithmonë kam punuar me korrektësi, me përkushtim duke zbatuar ligjin në të gjitha detyrat e mia. Domethënë, mund të them fjalë të bukura sa të duash, por po them shkurt dhe thjesht se çfarë prezantoj.

Erion Braçe – Faleminderit!

A kanë pyetje kolegët?

Fillojmë me zonjën Dhima, më pas zoti Xhelilaj dhe zoti Bushati.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

A mendoni se e njihni mirë ligjin e prokurimit publik dhe a mendoni se ka nevojë për ndryshime ai ligj?

Faleminderit!

Miranda Shkurta – Mendoj se e njoh relativisht mire, sepse çdo ditë atë ligj kam mbi tavolinë dhe them se ka vend për përmirësime. Domethënë, gjatë punës ne shpeshherë hasim probleme. Për shembull, një nga problemet lidhet me ankesat që bëhen. Bëhet ankesa në KPP. Pas kësaj anekse, ka fituar njëri vendin e parë dhe i dyti bën ankesën. KPP-ja ia jep ankimuesit. Tani, vendimi i KPP-së është i formës së prerë, por, faktikisht, ky i vendit të dytë ka të drejtën e ankimit dhe ankohet përsëri në KPP, e cila e drejton, sipas ligjit, në gjykatë. Normalisht,

procedura në gjykatë vazhdon, ai nuk është se i kthehet më kësaj procedure dhe e fiton. Kështu që kam përshtypjen se duhen specifikuar pak më saktë këta hapa të procedurës.

E dyta, mendoj se ajo oferta anomalisht e ulët, është një tmerr i vërtetë, sepse, duke ardhur dikush me ofertë, ne mendojmë se i kursejmë buxhetin, por nuk do të kemi cilësinë dhe standard në punë. Kështu mendoj se duhet ta eliminojmë këtë ofertë komplet. Ka plot gjëra, sepse duke punuar dalin edhe probleme. Herë pas herë ka vend për përmirësime, sepse asnjëherë nuk ka fund.

Erion Braçe – Me falni, se po e dëgjoj shpesh këtë punën e ofertave **anomalisht** të ulëta. Ju mendoni se gjithmonë është problemi i subjekteve që ofrojnë oferta anomalisht të ulëta dhe nuk e shihni fare si mundësi që entet prokuruese të kenë llogaritur gabim fondin limit?

Miranda Shkurti – Tani, unë flas të paktën për dikasterin ku ne punojmë. Mendoj se është një sektor më vete për fondin limit, që e llogarit dhe ka bazën ligjore mbi të cilën e llogarit fondin limit, si dhe ka një limit për llogaritjen e tyre.

Por unë them se oferta anomalisht e ulët do të ndikojë në cilësi, të paktën edhe nga praktika që kemi, sepse ai vjen vetëm për ta fituar dhe vjen me një ofertë shumë të ulët. Nuk besoj se është te fondi limit, por tek operatori.

Thjesht për ta fituar.

Madje unë do të shkoja edhe më tej dhe do të mendoja që, siç e kanë edhe vendet europiane, të bëhet një listë e operatorëve më të suksesshëm në punë dhe të kenë një koeficient plus në vlerësim, se ne na hyn çdo lloj operatori, i cili nuk ka as përvojë. Ai thotë: ta sjell një përvojë sa e ke kërkuar ti, në bazë të ligjit, por nuk e jep atë cilësi që e bëjnë operatorët më të mirë. Ndoshta duhet bërë një listim i operatorëve më të mirë dhe ato të kishin një koeficient plus në vlerësim.

Erion Braçe –...konkurrencë, zonjë.

Miranda Shkurti – Shkakton konkurrencën?! Por...

Erion Braçe – Ata mund të kenë dhjetë vjet në treg, vij unë...

Miranda Shkurti – Jam shumë dakord.

Erion Braçe – ...jam burrë shumë më i mirë sesa të gjithë ata, mund të ofroj cilësi shumë më të mirë. Pse duhet të penalizohem unë?

Miranda Shkurti – Jam shumë dakord, por ato kanë dhënë prova që kanë bërë një punë me cilësi.

Erion Braçe – Patjetër. Po unë?

Unë mund të punoj shumë më me cilësi se ata, prandaj kam hyrë në treg.

Miranda Shkurti – Nëse ti ke hyrë sot në treg, nuk ma do mendja...

Erion Braçe – Patjetër. Hyj sot në treg dhe mund të jem më i miri nga të gjithë të tjerët.

Miranda Shkurti – Nejse, unë mendoj që operatorët më të suksesshëm duhet normalisht të kenë një listim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Urdhëroni, zoti Xhelilaj!

Roland Xhelilaj – Faleminderit!

Unë kam vetëm një pyetje.

Në CV-në tuaj vërej se për vite të tëra keni punuar në Sektorin e Prokurimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve. Desha të pyes, si e vlerësoni Sektorin e Prokurimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe si ndikon puna që ju keni bërë atje për ta transmetuar pozitivisht në Komisionin e Prokurimit Publik?

Miranda Shkurti – U bënë mbi dhjetë vjet që unë punoj në atë sektor dhe vërtet jemi munduar në çdo moment, në çdo kohë që të përshtatim bazën ligjore dhe ta zbatojmë në mënyrë maksimale. Jemi munduar që t'i bëjmë kriteret gjithnjë në mënyrë të drejtë dhe jo diskriminuese, transparente, domethënë të gjitha.

Mendoj se kanë qenë pak a shumë pozitive, nisur edhe nga kontrollet që ne kemi pasur dhe nga të gjitha nuk është se kemi pasur probleme me Njësinë e Prokurimit.

Për sa u përket ankesave për dokumentet standarde dhe për kriteret, kanë qenë shumë të vogla, për të mos thënë nuk ka pasur, ndërkohë që ka gjithnjë vend për përmirësim. Domethënë, ne punojmë çdo ditë dhe çdo ditë...

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Ervin Bushati – Faleminderit!

Shikoj se keni punuar në shtet dhe, pak a shumë, kjo është edhe pyetja: a do të dini ju të mbronin edhe interesin e kompanive publike? Sepse ju vërtet thonin se ka oferta të termit “anomali”, por shpeshherë në Shqipëri ajo që ndodh, sidomos tek tenderët e rëndësishëm, është se janë katër, pesë, gjashtë firma dominuese në treg, janë praktika që njihen edhe në botë si: marrëdhënia kartel, bashkëpunojnë, futen të gjashtë firmat kryesore me një çmim të 99,5% deri 99,7% e vlerës limit dhe ai tjetri, që hyn si i ri, në radhë të parë, sapo futet në treg; e dyta,

teknologjia e ka lejuar gjithmonë dhe, falë Zotit, e lejon në botë që të ketë vlera edhe shumë më të ulëta, ndodh që janë reale...

Miranda Shkurti – Jo...

Ervin Bushati – A mendoni se do të dini t’u bëni ballë këtyre presioneve? Sepse, në qoftë se keni punuar gjithë jetën në shtet, le të themi, në shumicën e kohës, kuptohet se në shtet duhet të ecësh konform asaj që të thotë edhe shefi, edhe drejtori. Këtu tani kërkohet një vendimarrje më e rëndësishme.

Ne e kemi kthyer një proces të tërë, pasi mendonim se njerëzit që erdhën ishin të papërshtatshëm pikërisht për këtë: do të duhet të mbajnë një presion shumë të madh. Nuk ka të bëjë as me aftësinë ligjore, sepse të gjithë kanë bërë aq shkollë, as me konformizmin që vjen duke qenë pjesë e shtetit dhe e një strukture, por ka të bëjë me një vendimarrje të rëndësishme që ka të bëjë edhe me moralin, edhe me integritetin. Pra, edhe disa thonë dhe hyjnë në kartel, të shtyjnë drejt një vendimi, kjo do të kërkojë një vendimarrje më të rëndësishme sesa thjesht brenda ligjit. Patjetër, gjithçka që është bërë, është brenda ligjit në Shqipëri në shumicën e rasteve dhe përsëri ka pasur abuzim me tenderë; vazhdon historia.

Shpresojmë që të bëhet më mirë, sepse nuk ka qenë perfekte!

Faleminderit!

Miranda Shkurti – Atëherë, mendoj se presioni edhe aty ku jemi, është vërtet shumë i madh. Nuk e di se sa, por në Autoritetin Rrugor Shqiptar është vërtet presion shumë i madh, si të Njësia e Prokurimit, ashtu edhe tek të gjithë sektorët e tjerë.

Dhjetëvjeçari që unë kam kaluar, është falë punës që bëj, domethënë, duke zbatuar ligjshmërinë në mënyrën sa më të drejtë.

Mendoj se, edhe nëse do të jem nesër në Komisionin e Prokurimit Publik, do ta zbatoj ligjin dhe do ta gjykoj çështjen në mënyrë sa më të drejtë dhe të argumentuar sa më saktë, për të bindur edhe operatorët ose ankimuesit për vendimin që do të jap.

Dua të jem gjithmonë e paanshme, duke vepruar gjithnjë në zbatim të ligjit dhe duke besuar në integritetin tim.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Çështja është të bindësh kryetarin e komisionit...

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zonjë, për prezantimin tuaj!

Jeni e lirë të largoheni!

Miranda Shkurti – Ju falënderoj dhe ishte kënaqësi!

Erion Braçe – Faleminderit!

Të vijë kandidati tjetër.

Rozeta Ivanova – Përshëndetje!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Ivanova, për prezencën tuaj!

Jeni këtu për të dhënë opinionin tuaj lidhur me prokurimet publike, si dhe për të dhënë një ide tuajën për Komisionin e Prokurimit Publik, për shkak të një propozimi të Këshillit të Ministrave që ju propozon pranë Kuvendit të Shqipërisë si kandidate për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Kështu që do të donim një prezantim nga ana juaj dhe, nëse kolegët deputetë do të kenë interes apo pyetje lidhur me prezantimin tuaj, jeni e lutur të na jepni disa përgjigje.

Fjala është për ju, dhjetë minuta.

Rozeta Ivanova – Jam Rozeta Ivanova dhe që prej vitit 2003 jam juriste e Zyrës së Buxhetit Gjyqësor, çka do të thotë se me prokurimet kam një eksperiencë prej 15 vjetësh.

Për mua është realisht kandidimi i tretë, sepse kam kandiduar edhe për kreun e KQZ-së më parë dhe tek organet e vettingut. Për shkak se kandidimet e mia kanë qenë totalisht të pavarura dhe nuk kam pasur mbështetje politike, në fakt, nuk u përzgjodha në dy kandidimet e mëparshme, edhe pse i plotësoja të gjitha kriteret qoftë ligjore, qoftë të kërkuara për pozicionet përkatëse.

Megjithatë, nuk jam demoralizuar nga kjo, ndaj jam përsëri këtu, në Kuvend, dhe kandidoj për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për prokurimet mund të flas shumë për shkak të eksperiencës së gjatë. Unë kam qenë non stop në të gjitha prokurimet që ka zhvilluar Zyra jonë, në kuadër të infrastrukturës në gjyqësor, përmirësimit të vazhdueshëm për të arritur standardet që kërkohen.

Dihet se prokurimet janë një sferë disi e ndjeshme për publikun e gjerë, për faktin se ka të bëjë me mënyrën se si menaxhohet paraja publike nga institucioni përkatës. Në këtë kuptim, i bie që janë të ndjeshme, por qoftë procedurat, qoftë lidhja apo zbatimi i një kontrate publike, në rast se nuk bëhet ashtu siç e kërkon ligji apo devijohet ligji, apo abuzohet me ligjin, madje më keq akoma, me synimin për të vjedhur apo për të bërë korrupsion për shkak të tenderimeve, kjo pastaj krijon një raport shumë të rëndë të vetë shtetit me shoqërinë, sepse, në fund të fundit,

operatorët publikë janë pjesë e biznesit, janë pjesë e shoqërisë dhe për këtë arsye tenderimet janë një fushë shumë e ndjeshme.

Për të qenë realistë, sa herë që njerëzit e thjeshtë dëgjojnë që në iks institucion apo bashki, a ku ta di unë, ku është bërë korrupsion me iks apo ypsilon tender, ka një konotacion negativ për shtetin apo për institucionet, gati deri neveri duke thënë: “Ja, shikoni çfarë bëjnë zyrtarët me tenderimet publike”.

Personalisht gjykoj se çdo zyrtar, çdo funksionar që merret me tenderimet duhet, në radhë të parë, ta ketë në karakter, ta ndiejë vetë që, shiko, tenderimit duhet t’ia zbatosh procedurat dhe të gjitha aspektet e tjera në mënyrë korrekte me ligjin, sepse, në fund të fundit, nëse nuk është kështu, i bie që po dëmton veten tënde, pasi je taksapagues, ashtu siç jemi të gjithë; dëmton të ardhmen e fëmijëve të tu, si dhe në fund të gjithë shoqërinë e vendit ku ti jeton dhe mundohesh të kontribuosh, me mish e shpirt, por nganjëherë varet se si funksionojnë gjërat.

Ky ishte pak a shumë prezantimi im.

Dua të them edhe një gjë të fundit, që e kam me merak dhe, në rast se nuk e them, do ta kisha vërtet me merak kur të dal nga kjo sallë.

Jo për shkak të dy kandidimeve të mëparshme, por unë jam pjesë e minoritetit bullgar në Shqipëri (i cili është njohur së fundi edhe me ligj nga Kuvendi) dhe, siç e dini, ai shtet i ka mbështetur qoftë Shqipërinë, qoftë shqiptarët. Do të doja shpirtërisht që prej jush të kisha një mbështetje edhe për këtë arsye.

Erion Braçe – Faleminderit!

Ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme mbështetëse të Buxhetit Gjyqësor...

Rozeta Ivanova – Quhet ndryshe: Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Ervin Bushati – Është pranë Gjykatës...?

Rozeta Ivanova – Si godinë është pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda, por ne kemi funksionuar me ligj...

Ervin Bushati – Është e pavarur.

Rozeta Ivanova – Po, është institucion i pavarur, por për shkak të reformës, Zyra është shkrirë dhe do të risistemohet, në bazë të ligjit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Ervin Bushati – Është shkrirë.

Rozeta Ivanova – Do të risistemohet i gjithë stafi.

Ervin Bushati – Atëherë, pyetja e parë është: çfarë projekti keni ju, që mund të ndikoni mbi vendimmarrjen dhe si mund të shikohen më mirë çështjet? Ideja është kjo: ne me të vërtetë e kthyem gjithë procesin, pikërisht që të kishim disa kualitete më të mira se sa ato që kaluan herën e fundit dhe, në fakt, deri tani kemi parë, në mendimin tim personal, kualitete më të mira se ato të herës së fundit.

Çfarë mendoni se mund të bëni aty brenda një trupe, që mund të ketë një konformitet të caktuar, mund të ketë një vendimmarrje që shpeshherë mund të mos jetë (brenda ligjeve duket mirë gjithçka dhe në Shqipëri ju e keni parë këtë)? Pra, çfarë mund të bëni ju më shumë brenda kësaj strukture për të ndikuar që të zbatohet qoftë ajo që është në ligj, qoftë ajo që është brenda një morali dhe integriteti për të ruajtur fondet publike, që janë të të gjithë shqiptarëve?

Faleminderit!

Rozeta Ivanova – Së pari, mendoj se e gjithë struktura e KPP-së mund të organizohet edhe më mirë. Megjithatë, ky është një proces, që për më tutje nuk mund ta them unë tani, pa parë nga brenda se si ose ku janë problemet ose ku janë evidentuar problemet që ka ai institucion, sepse KPP-ja është institucion më vete.

Së dyti, gjykoj që uniformiteti i vendimeve që jep KPP-ja do të rriste nivelin e vendimmarrjeve të KPP-së. Për mendimin tim, KPP-ja mund të rishikohet në ligjin e prokurimit në mënyrë që të jetë e sqaruar më mirë, sepse ka momente në të cilat ...

Jam dakord që ligji nuk i përmend të gjitha, sepse janë aktet nënligjore ato që rregullojnë veprimtarinë dhe funksionimin e një institucioni përkatës, megjithatë, në këtë kuadër të nxjerrjes së vendimeve uniforme mund të thuhet diçka edhe në ligjin e prokurimit. Mund të ketë edhe gjëra të tjera teknike, por ndoshta duhet një mendim nga ekspertët për të riparë ligjin e prokurimit për sa i përket KPP-së.

Erion Braçe – Faleminderit!

Ju punoni pranë zyrës së administrimit të buxhetit gjyqësor? Ka komision prokurimi atje?

Rozeta Ivanova – Për shkak se jemi institucion i vogël, ne nuk kemi një strukturë të dedikuar për këtë gjë, por pas çdo procedure ne ngremë njësinë e prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Erion Braçe – Pra, nuk është një strukturë permanente që merret me ...

Rozeta Ivanova – Nuk është strukturë permanente, por e ngritur me urdhër të titullarit pas çdo procedure.

Erion Braçe – Kjo është e ndryshueshme apo është konstante?

Rozeta Ivanova – E kemi të ndryshueshme vetëm në rastin kur na nevojiten specialistë të jashtëm për tenderimet e punëve publike. Për tenderët e ndërtimit marrim specialistë nga jashtë, sepse nuk i kemi kapacitetet e brendshme.

Erion Braçe – Prokurimi Publik është një komision permanent?

Rozeta Ivanova – Është permanent, sepse vetë punonjësit lëvizin nga njëri komision në tjetrin, kurse unë jam *non stop* në njësi, sepse jam juriste.

Erion Braçe – Faleminderit!

Rozeta Ivanova – Faleminderit, ju! Punë të mbarë!

Erion Braçe – Vazhdojmë me kandidatin tjetër.

Mirëdita, zonja Ago!

Duam të dëgjojmë një prezantim jo vetëm tuajin personal, sepse CV-në tuaj kolegët e kanë mbi tavolina, por të idesë suaj për prokurimet publike dhe mbi të gjitha të idesë suaj për komisionin e prokurimit publik, për një vend anëtar i të cilit jeni propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kështu që, fjalën e keni ju për dhjetë minuta. Më pas, në rast se kolegët deputetë kanë pyetje për prezantimin tuaj, do t'i adresojnë dhe ju jeni e lutur të na jepni disa përgjigje. Fjala është për ju.

Miklovana Ymerali Ago – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit!

Së pari, ju falenderoj për mundësinë që më keni dhënë për të qenë e pranishme sot në këtë mbledhje të komisionit.

Quhem Miklovana, kam lindur në Skrapar, shkollën e mesme e kam kryer në Korçë, kurse studimet e larta në fakultetin e drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Jam diplomuar në studimet pasuniversitare master në shkencat penale po në fakultetin e drejtësisë.

Punën time e kam filluar si juriste në Universitetin Politeknik të Tiranës, në rektorat, në vitin 2006, ku kryesisht jam marrë me zhvillimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit

publik. Në qershor të vitit 2007 kam filluar detyrën si inspektore pranë Autoritetit të Konkurrencës, fillimisht në drejtorinë juridike dhe nga maji i vitit 2017 jam inspektore në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese. Gjatë ushtrimit të detyrës sime prej një kohe gati 11 vjetësh kam qenë pjesë e grupeve të ndryshme të punës, të cilat kanë qenë përgjegjëse për zhvillimin e procedurave hetimore administrative në tregje të ndryshme të ekonomisë në kuadër të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku një vend të veçantë zënë edhe koncesionet si të drejta të veçanta ekskluzive, si dhe tregjet e prokurimeve publike.

Kam bërë trajnime të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit, si në fushën e konkurrencës ashtu edhe atë të prokurimeve. Kam qenë pjesë e grupit të draftimit të udhëzimit mbi luftimin e marrëveshjeve në oferta në prokurime publike, i cili ka shërbyer si metodologji për kryerjen e procedurave hetimore në tregjet e prokurimeve. Ky udhëzim është publikuar edhe në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik për t’u ardhur në ndihmë punonjësve të prokurimit gjatë procesit të prokurimit për njohjen e këtyre formave të bashkëpunimit midis operatorëve ekonomike, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e marrëveshjeve me oferta në prokurimet publike. Kam qenë aktive në vlerësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si në kuadër të hetimeve në tregje të ndryshme, duke vlerësuar kuadrin ligjor rregullator të këtyre tregjeve, ashtu edhe në vlerësimin e projektakteve të paraqitura për mendim. Gjithashtu, kam ndjekur procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave të paraqitura në autoritet, ku nuk kanë munguar edhe ankesat lidhur me tregjet e prokurimeve.

Në kuadër të këtyre vlerësimeve ligjore janë dhënë rekomandime për rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit, si dhe parandalimin e marrëveshjeve në oferta, në prokurime, rekomandime të cilat kanë prekur si kuadrin ligjor ashtu edhe atë rregullator. Për një kohë të gjatë kam luajtur edhe rolin e administratorit të sistemit të prokurimeve elektronike të autoritetit dhe aktualisht janë caktuar si persona përgjegjës për procedurat e prokurimit.

Njohja me tregjet e prokurimeve publike ka qenë prioritet i vazhdueshëm në kuadër të detyrave të mia si inspektore e Autoritetit në respektim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Pjesëmarrja ime e vazhdueshme në procedura të ndryshme të prokurimit publik ka bërë që të jem në kontakt me njohje të vazhdueshme me ndryshimet ligjore të kësaj fushe.

Nisur nga përvoja ime dhe njohuritë e marra, si në fushën e konkurrencës, ashtu edhe atë të prokurimeve, një nga prioritetet e mia si anëtare e komisionit do të jetë rritja e konkurrencës për procedurat e prokurimit.

Duke qenë se në një procedurë prokurimi dy janë aktorët kryesorë, autoriteti kontraktor nga njëra anë dhe operatorët ekonomikë nga ana tjetër, thirrja e këtyre ndikon në ecurinë dhe rezultatin e këtij procesi.

Në këtë mënyrë, procesi ndikohet drejtpërdrejt nga mënyra e planifikimit të një procedure prokurimi dhe vendosjes së kërkesave dhe kritereve për kualifikim nga ana e autoritetit kontraktor.

Me qëllim realizimin e një prokurimi të suksesshëm, Autoriteti duhet të përcaktojë kërkesa shumë të qarta, të shprehura saktë nga ana sasiore dhe të shoqëruara me argumentet përkatëse dhe me specifikime teknike të hartuara me përgjegjësi. Kjo fazë është shumë e rëndësishme edhe për Komisionin e Prokurimit Publik në rast të shqyrtimit të ankesave lidhur me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi, pavarësisht mbështetjes së tyre në lidhje me rregullat e prokurimit, ato përbëjnë barrierë për hyrësit në treg, sidomos për operatorët e vegjël dhe të mesëm ekonomikë.

Nga ana tjetër, sjellja e operatorëve ekonomikë duhet parë, interpretuar dhe vlerësuar, jo vetëm nga aspekti procedural në respektimin e ligjit për prokurimin, por edhe në raport me njëri-tjetrin, zgjedhje kjo, e cila është vendimtare për procesin konkurrues të prokurimit dhe rezultatet e tij.

Konkretisht, kur operatorët ekonomikë sillen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, ofertojnë në mënyrë të pavarur, atëherë do të kemi rezultate konkurruese dhe përdorim efektiv të fondeve buxhetore. Mund të ndodh edhe e kundërta, që këta operatorë të interesuar për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si në fazën e përgatitjes së ofertave ashtu edhe gjatë ofertimit dhe pas shpalljes së fitues. Kjo sjellje e kundërligjshme sjell efekte negative me pasoja të rënda për buxhetin dhe taksapaguesit, pasi do të paguhet shumë më tepër për një shërbim, mall apo punë të prokuruar sesa do të paguhej në një situatë konkurrence të lirë dhe të pavarur.

Bazuar në të drejtat dhe detyrimet që u njihen palëve në procesin e prokurimit, APP-së dhe KPP-së si organi më i lartë i fushës së prokurimeve, rritja e konkurrencës në tregjet e prokurimit publik do të mund të realizohet nëpërmjet disa mënyrave, si nëpërmjet zbulimit,

parandalimit dhe reduktimit të formave të bashkëpunimit të paligjshëm mes operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve publike.

Kjo do të arrihej nëpërmjet vlerësimit të specializuar të dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë shqyrtimit të ankesave dhe vlerësimit të sjelljes së operatorëve gjatë procedurës së ankimimit. Parandalimi dhe zbulimi i këtyre formave të bashkëpunimit është shumë i rëndësishëm për shkak se marrëveshjet me oferta sjellin mungesë të konkurrencës, oferta fituese me çmime shumë më të larta si në kushtet e një konkurrence të pavarur, keqpërdorim të fondeve publike, si dhe ulin besimin publik në një proces konkurrues.

Kjo arrihet nëpërmjet trajnimit të zyrtarëve të prokurimit publik për firmat që bëjnë marrëveshje, faktorët që mundësojnë ato, si dhe projektimin e prokurimeve me qëllim shmangien e bashkëpunimeve të tilla nëpërmjet rritjes së transparencës në procesin e trajtimit të ankesave, rritjen e ndërgjegjësimit të palëve të përfshira në procedurat e prokurimit publik, si dhe rritjes së konkurrencës nëpërmjet trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në procedurat e prokurimit publik nëpërmjet eliminimit të barrierave të panevojshme të vendosura nga autoritetet kontraktore në formën e kriterëve për kualifikim “duke abuzuar” me pavarësinë dhe hapësirat që ju jep ligji dhe rregullat e prokurimit publik.

Bazuar në eksperiencën time relativisht të gjatë në fushën e konkurrencës dhe atë të prokurimeve, si inspektore në një institucion të pavarur në kryerjen e detyrave të mia, ku anëtarët e organit të vendimmarrjes zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, jam njohur edhe me natyrën procedurale të punës si një organ kolegjal i përhershëm, gjë e cila mendoj se ndikoi pozitivisht në ushtrimin e detyrës sime si anëtare e një komisioni, i cili po shkon drejt pavarësisë së tij të plotë në vendimmarrje.

Duke vlerësuar rëndësinë e veçantë të komisionit, do të përpiqem të jap kontributin tim maksimal bazuar në integritetin, paanshmërinë, mosdiskriminimin, trajnimin e barabartë të operatorëve, transparencën, efikasitetin dhe eficiencën në nxjerrjen e vendimeve të drejta brenda afateve ligjore me qëllim rritjen e konkurrencës dhe mirëmenaxhimin e fondeve publike.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonjë!

Ka pyetje?

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Me sa shikoj, ju keni një eksperiencë të madhe në Autoritetin e Konkurrencës. Këtë unë e shikoj si pikë të fortë, por edhe si sfidë për të ardhmen. Duke punuar në Autoritetin e Konkurrencës ju e keni parë që ai institucion, pak a shumë, është kthyer në një organ akademik që vëren, por nuk fiton çështje në gjyq, nuk ka ndryshuar sjelljen e konsumatorit apo sjelljen e karteleve kryesore. Të gjithë e dimë që ato që kanë pozita dominuese në treg, kanë edhe tregun, marrin edhe tenderët dhe ..

AK-ja ka qenë aty, por për shumë arsye nuk ka sjellë ndonjë ndryshim. Ju çfarë do të bëni ndryshe? Jo vetëm të mbani dokumentet dhe të shikoni nëse zbatohet ligji. Zbatohet apo nuk zbatohet ligji, ju vini raportoni dhe nuk ka ndryshuar ndonjë gjë në treg për t'u imponuar KPP-së, prokurorisë, gjykatave dhe çështjet nuk fitohen në gjyq.

Çfarë do të bëni ndryshe dhe cilat do të ishin disa pika të strategjisë suaj, jo vetëm për të qenë brenda ligjit, sepse në KPP gjithmonë brenda ligjit është funksionuar në 20 e ca vjet, ndërkohë që ne e dimë çfarë bëhet me tenderët publikë?

Jo vetëm njohja e ligjit është konformizmi për të qenë bashkë me ekipin dhe për të mbajtur letrat në fund të ditës. Çfarë do të ndryshonit diçka brenda nesh, jush apo institucionit për ta bërë të fillojë të funksionojë? Ne po bëjmë një proces serioz këtë herë. Herën e parë e anulua për arsye objektive, por këtë herë kemi kandidaturën më të mirë. Duhet të ndryshojë diçka reale. Çfarë mendoni se mund të sillni, jo thjesht duke lexuar dhe duke qenë konform gjithçkaje?

Faleminderit!

Miklovana Ymerali Ago – Mendoj se do të sjell rritjen e ndërgjegjësimit duke filluar nga zyrtarët më të thjeshtë të prokurimeve publike, që merren me procedurat dhe janë në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorët dhe procedurat e prokurimeve publike, ndërgjegjësimin e tyre për të gjitha format e marrëveshjeve, si nga ana e operatorëve ekonomikë, ashtu edhe nga qëndrimi që duhet të mbajnë ata kundrejt operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, duke filluar me ndërgjegjësimin edhe në fazat më lart në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe vetë Komisioni i Prokurimit Publik do të jetë më efikase dhe praktike në luftën ndaj sjelljeve antikonkurrese, antiligjore dhe antiligjit të prokurimit publik.

Ne do rrisim konkurrencën, efektivitetin dhe ndërgjegjësimin nëpërmjet formave të ndryshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, zyrtarët e prokurimit.

Ervin Bushati – Zyrtarët e prokurimit u binden atyre që i kanë emëruar si anëtar të komisionit të prokurimit. Nuk është kaq e thjeshtë të ndërgjegjësohen, të paktën më duket mua. Kur emërohen disa juristë nga kryetari i komisionit që u thotë se do të bëhen këto procedura, ndërgjegjësimi apo ndoshta frika nga ligji?

Miklovana Ymerali Ago – E kisha për ndërgjegjësimin me njohjet shitesë, sepse sigurisht, duhet të jenë të njohur dhe të përditësuar me ligjin dhe ta kenë frikë atë. Normale, në punën që kemi, duhet ta respektojmë ligjin dhe ta vëmë atë mbi të gjitha.

Erion Braçe - Ju jeni marrë me prokurimet publike? Ju pyes edhe për vlerësimin që do të bëhet më pas.

Miklovana Ymerali Ago – Po.

Erion Braçe – Ku?

Miklovana Ymerali Ago – Fillimisht, njohuritë e mija të para i kam marrë që në vitin e parë të punës sime që ka qenë kryesisht me prokurimet publike. Jam marrë vit pas viti edhe me procedura të ndryshme që zhvillohen në Autoritetin e Konkurrencës.

Erion Braçe – Keni mbuluar këtë sektor në Autoritetin e Konkurrencës?

Miklovana Ymerali Ago – Po, si inspektore. Meqenëse nuk kemi specialistë prokurimesh, kam ndjekur edhe procedurat e prokurimit.

Erion Braçe – Dakord. Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit shumë, zonjë!

Të vijë kandidati tjetër!

Zoti Mata, do të donim një prezantim të shkurtër nga ju, jo aq personal, sepse CV-ja juaj është para kolegëve, por idetë tuaja për prokurimet publike, situatën aktuale të tyre dhe atë që sipas mendimit tuaj, gjykoni se mund të ndryshohet apo mund të përmirësohet në Komisionin e Prokurimit Publik.

Fjala për ju për të bërë prezantimin tuaj!

Lulzim Mata - Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Ju falënderoj për mundësinë dhe për hapësirën që më keni krijuar për të qenë i pranishëm në këtë mbledhje të komisionit.

Unë jam diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë, në vitin 2000. Një vit pas përfundimit të studimeve kam punuar për Kryqin e Kuq Spanjoll.

Nga viti 2001 deri më sot, jam fokusuar në fushën e prokurimeve publike. Fillimisht, kam punuar si specialist prokurimesh pranë Komandës Logjistike në Ministrinë e Mbrojtjes.

Nga viti 2007 e në vazhdim, punoj në ARRSH, si përgjegjës i Sektorit Prokurimeve të ish-Drejtorisë së Rrugëve.

Jam para jush për të kërkuar mbështetjen tuaj dhe një rekomandim pozitiv për të qenë pjesë në Komisionin e Prokurimit Publik, sepse mendoj që jam në gjendje të përfaqësoj dhe të mbroj denjësisht të drejtat e mohuara të operatorëve ekonomikë në mënyrë direkte nga gabimet me dashje apo nga pakujdesia e autoriteteve kontraktore.

Meqenëse kam një karrierë relativisht të gjatë në këtë fushë, kam punuar në funksione të ndryshme në fushën e prokurimit, si pjesë e ministrisë, si anëtar i KVO-së, si shqyrtues ankesash, si administrator sistemi, si pjesë e projektit pilot të prokurimit me mjete elektronike dhe një vit më pas, si përgjegjës i Sektorit Prokurimeve të ish-Drejtorisë së Rrugëve.

Gjykoj se jam në gjendje ta kryej detyrën për të cilën kam aplikuar. Gjatë gjithë kësaj periudhe kam dëshmuar në mënyrë të prerë ndjeshmërinë, maturinë dhe respektin ndaj ligjit në çdo hap të punës sime.

Kur vendosa të aplikoj për këtë detyrë, gjëja e parë që më erdhi ndër mend ishte përgjigja e pyetjes se çfarë është bërë gabim dhe çfarë do të përmirësoja, nëse do të isha unë pjesë e një vendimmarrjeje të tillë.

Bazuar në rregullat e prokurimit publik në fuqi, vendimmarrja e KPP-së është me shumicë votash, çka nuk mund të ndryshojë faktin që një anëtar i vetëm nuk mund të ndryshojë fatin e çështjes, por të paktën, ju siguroj se debati për një çështje do të jetë gjithmonë objektiv dhe në të kundërt, në mendimin e pakicës, disponuesi i së drejtës, duhet të gjejë gjithmonë veten.

Në lidhje me çështjet që sipas gjykimit tim janë konceptuar gabim deri më sot, duke u marrë vendime të padrejta dhe jo objektive janë disa.

Vendimet e KPP-së përgjithësisht nuk mbajnë parasysh qëllimin e ligjit që të sigurojnë për përdorimin e fondeve publike, duke ulur shpenzimet procedurale. Mosparaqitja e dokumenteve të kërkuara nga kriteret për kualifikim, jo çdo herë përmbush qëllimin e nenit përkatës të rregullave të prokurimit publik për kualifikimin e subjekteve.

Qëndrimi “shumë i prerë” i KPP-së në shumë raste ka skualifikuar operatorë ekonomikë, të cilët edhe pse kanë pasur të meta shumë të vogla, kanë ofruar çmime shumë të leverdishme për buxhetin e shtetit. Sipas gjykimit tim, kjo duhet ndryshuar, duke pasur në konsideratë vetëm ato kritere që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në realizimin e kontratës, dhe jo të dokumenteve që plotësojnë njëri-tjetrin ose mund të qëndrojnë edhe pa njëri-tjetrin.

Ka pasur mjaft raste, kur KPP-ja ka skualifikuar operatorë ekonomikë që janë renditur në vend të parë nga autoritete të ndryshme kontraktore që kanë pasur ofertë më të ulët.

Po marr një rast. Për mungesë të lejes së bashkisë për pajisjen me mjete borëpastruese në Korçë është kualifikuar operatori i fundit në renditje. personalisht mendoj se ofertat e leverdishme duhet të vlerësohen, duke marrë në konsideratë devijimet e vogla që parashikon ligji.

Në shumicën e vendimeve është shkelur parimi i barazisë para ligjit të personave juridikë. Në këtë rast operatorët ekonomikë nuk vihen në të njëjtin emërues të përbashkët (nëse mund të shprehem kështu), duke mos zbatuar të njëjtat shkallë gjykimi në bazë të dokumenteve të paraqitura. Pra, ka pasur qëndrime të ndryshme në lidhje me të njëjtin objekt shqyrtimi administrativ.

Në rast se një operatori ekonomik i merret me të drejtë nga KPP-ja atëherë një tjetër operator ekonomik duhet të marrë të drejtën që i takon, gjë që në shumë vendime që unë kam lexuar, nuk ka ndodhur.

Afati për shqyrtimin e ankesave nga KPP-ja edhe pse me ndryshimet e fundit ligjore janë shkurtuar, në pjesën e dytë, nuk zbatohen. As afati 20-ditor i mëparshëm nuk zbatohet duke lënë çështjet pezull (ka pasur raste edhe për 1 vit). Kjo është e papranueshme pasi tashmë ka humbur qëllimin për të cilin ka një urdhër prokurimi nga autoriteti kontraktor për realizimin e (...) të autoritetit kontraktor. Afati i çështjeve procedurale në këtë rast i shkelur, duhet të çojë deri në anulimin e vendimit, si vendim me tejkalim të afateve ligjore. Kjo do të sillte pasoja për personat përgjegjës.

Gjykimi në kundërshtim me Kodin e Procedurave Administrative, duke mos njoftuar të gjitha subjektet që u preken interesat nga një vendim i KPP-së. Thuhet në të gjitha rastet KPP-ja kur ka dhënë ndonjë vendim, nuk ka marrë ndonjë informacion ose nuk ka pyetur palën ankuese dhe palën që i cenohet e drejta nga vendimi me qëllim që vendimi të jetë administrativisht përfundimtar dhe palët e interesuara në këtë mënyrë të kishin të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative, si gjykatë kompetente.

Mendoj se duhet bashkëpunuar me Agjencinë e Prokurimit Publik dhe çdo organ tjetër që merr pjesë në një procedurë prokurimi apo e heton atë që të unifikohet çështja dhe të zbatohet njësoj nga të gjithë. Vetë APP-ja raste të ngjashme i ka skualifikuar dhe i ka konsideruar të padrejta dhe justifikuese për KVO-në, nëse ata kanë zbatuar të njëjtin rast për analogji.

Vendime të paqarta të APP-së, me terma latine, me qëllim dhënien e një imazhi të operatori ekonomik se po jepet një vendim i drejtë, pavarësisht se ata as nuk kanë idenë se për çfarë bëhet fjalë. Në praktikën ndërkombëtare dhe në vendin tonë për procedurën e prokurimit publik përdoren dokumente standarde. Formulari i ankesës është vënë me qëllim që operatorët ekonomikë të mund të hartojnë ankesat, duke përmbushur kërkesat formale dhe të përmbajtjes, pa pasur njohuri të veçanta në fushën juridike. Të arrish të kuptosh siç duhet një vendim të KPP-së, duhet të kesh jo vetëm njohuri në këtë fushë, por edhe të gjuhës latine për shkak të mbingarkesave në fjalor me qëllim vetëm konfuzionin të palët e interesuara.

Po kështu, unë nuk gjej qoftë edhe një rast të KPP-së, e cila dhe pse ka marrë mijëra vendime në gjithë këto vite, të ketë përjashtuar qoftë edhe një operator të vetëm për paraqitje dokumentesh të rreme në kualifikim ose të falsifikuara.

Edhe pse këto ditë ka ndryshuar një pjesë të mirë të vendimeve, në asnjë rast nuk ka propozuar masa ndaj zyrtarëve që kanë shkelur me faj dhe në mënyrë të përsëritur ligjin për prokurimit publik.

Përveç sa theksova më sipër, gjykoj që vetë KPP-ja duhet të bëhet nismëtare për disa ndryshime ligjore për përmirësimin e punës dhe efikasitetin, pasi në fund të fundit është një organ që e njeh më së miri problematikën në lidhje me procedurat e prokurimit publik.

Ndryshimet duhet të prekin procedurat e tenderëve, kryesisht për kualifikim deri te pagesa me qëllim ankimin pranë KPP-së.

Operatorët ekonomikë duhet të paguajnë të njëjtën shumë edhe nëse ankohen për kërkesat për kualifikim. Në fakt ankesa nuk duhet të jetë thjesht dhe vetëm një çështje në interes të operatorit, por të një shtrese të gjerë, i cili nëse do të rishikojë këtë kërkesë do të mund të marrë pjesë në një procedurë konkurrimi duke shtuar konkurrencën dhe si pasojë, do të ketë oferta më të leverdishme për buxhetin e shtetit.

Kryesisht, kur kanë vlera të larta (koeficienti 0,55% e fondit limit është shumë e lartë si ankesë administrative.) Kujtoj faktin që ankesat me rrugë gjyqësore kanë vetëm pagesën e regjistrimit të kërkesë-padisë. Kjo në një farë mënyre i pengon operatorët ekonomikë të ankohen jo, sepse janë të bindur që nuk kanë të drejtë, por mund të humbasin pa të drejtë atë që kanë. Heqja e pagesës nuk duhet të ndodhë kurrësi, pasi do të bëhet shkak për vonesa të pajustificuara.

Një tarifë fikse për fonde limit të caktuara, mendoj se do të ishte zgjidhja më e mirë.

Ndryshimet ligjore për ofertat normalisht të ulëta. Këto ndryshime nuk kanë të bëjnë direkt me KPP-në, por në fakt nuk kanë gjetur rregullim prej kohësh dhe mendoj se do të ishte mirë të rishikoheshin.

Personalisht mendoj se për të eliminuar këtë oferta fituese do të ishte oferta më afër mesatares së ofertave të vlefshme. Në këtë formë eliminohet oferta e ulët dhe çdo tentativë për ndikimin në paracaktimin e fituesve.

Për të mos u zgjatur më shumë, në përshkrimin e problematikave që kam konstatuar dhe që në fakt janë shumë më tepër, nëse do të bëhesha pjesë e KPP-së, premtoj se debati konstruktiv me qëllim minimizimin sa më shumë të tyre, do të jetë gjithmonë prezent.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Mata!

Ka pyetje nga relatori? Nuk ka.

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Zoti Mata, ju keni qenë pjesë ose jeni në Autoritetin Rrugor Shqiptar prej vitesh. Ky është një nga entet prokuruese, që zë peshën kryesore në prokurimet publike në të gjithë buxhetin e shtetit dhe është një nga entet që është audituar më shumë nga KLSH. A jeni në dijeni të raporteve të KLSH-së për mënyrën e funksionimit dhe në raport me ligjin të KPP-së pranë ARRSH-së? Çfarë mendoni për këto auditime?

Lulzim Mata - Unë në fakt kam vite në ARRSH dhe jam audituar 4-5 herë nga KLSH-ja, kur kam qenë në funksione të ndryshme dhe nuk kam pasur asnjë masë të propozuar nga KLSH-ja, në të gjitha funksionet që kam kryer deri sot.

Erion Braçe – Çfarë mendoni për këto auditime të KLSH-së? Sa qëndrojnë ato dhe a është përmirësuar ndonjë aspekt i prokurimeve publike në ARRSH?

Lulzim Mata - Po, që nga viti 2007 që unë jam prezent, ka ndryshime pozitive. Një nga ndryshimet kryesore ishte zhvillimi i procedurave me mjete elektronike, pasi lejon një pjesëmarrje më të madhe. Këto ndryshime janë konstatuar edhe në raportin e KLSH-së. Tashmë dokumentet janë në sistem dhe mund të kontrollohen në çdo rast.

Në lidhje me auditimet e KLSH-së, mendoj se ai ka qenë më shumë financiar, pavarësisht se ka prekur edhe fushën e prokurimeve publike.

Gjykoj se është ulur ndjeshëm mënyra, forma ose mundësia për të abuzuar qëkur procedurat janë elektronike, sepse dokumentet janë tashmë të aksesueshme në sistem nga çdo person. Edhe kërkesat për kualifikim si pjesë e dokumenteve janë po në sistem. Kjo do të thotë se ka pasur pak gjëra për të ndryshuar në lidhje me procedurat, kryesisht vetëm për kërkesat për kualifikim, të cilat janë reflektuar herë pas here në vitin pasardhës.

Erion Braçe – Në vijim të kësaj pyetjeje dhe të shpjegimeve që dhatë, dëgjova që patët mendimin tuaj në lidhje me ofertat anormalisht të ulëta dhe si mund të kapërcehet kjo problematikë që është e konsiderueshme në fushën e prokurimeve publike.

Unë do t'ju pyesja: ju keni marrë pjesë në prokurime publike. Ndoshta nuk është kjo detyra juaj e drejtpërdrejtë, por ARRSH-ja a bën ndonjëherë kontroll të cilësisë së punimeve për ato kontrata që ka nënshkruar? Domethënë, është ndjekur kjo procedurë prokurimi, ju keni vendosur që fituesi të jetë X kompani për këtë objekt, për këtë vepër e të tjerat. Pasi ka ndodhur kjo, pasi është nënshkruar dhe është përmbushur kontrata, a jeni kthyer ndonjëherë për të parë se si vendimmarrja juaj në këto komisione të prokurimit publik ka ndikuar në cilësinë e një vepre?

Lulzim Mata - Pranë ARRSH-së organikisht ekziston edhe Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave. Sektori i Prokurimeve merret thjesht me procedurën e prokurimit dhe me kalimin e ...

Erion Braçe – Për këtë pjesë.

Lulzim Mata - Sektori i Prokurimeve merret thjesht me procedurën e prokurimit. I ngarkuar me menaxhimin e kontratave është mbikëqyrësi i punimeve, i cili është i detyruar të jetë çdo moment në kantierin e punimeve si dhe drejtoria përkatëse Menaxhimit të Kontratave.

Në lidhje me cilësinë e zbatimit dhe përpunimit të kontratave me sukses nuk është marrë në vazhdim Sektori i Prokurimeve, pasi i takon vendimmarrjes së drejtorisë tjetër përkatëse, por në praktikën tonë ka shumë pak kontrata, madje sivjet po shihet mundësia që të penalizohen për mosrealizim të kontratave dhe të dërgohet për përjashtim pranë prokurimeve publike.

Erion Braçe – Jo, shqetësimi im ka të bëjë me një gjë tjetër, me një analizë që unë mendoj se ARRSH-ja duhet ta bëjë të përbashkët qoftë me drejtorinë tuaj të Prokurimit publik qoftë dhe drejtorisë së analizës apo menaxhimit të këtyre kontratave, për të kuptuar se çfarë ka ndodhur, sepse, fjala bie, 10 lotët e rrugës nga Plepat deri në Rrogozhinë kanë mbaruar vjet, ndërkohë që prokurimi mund të jetë bërë tre – katër vjet më përpara.

Lulzim Mata – Ne vitet 2009-2010

Erjon Braçe – Pra, 10 vjet më përpara. Tani, a mund të kthehemi pas dhe të bëjmë një analizë të prokurimit se si është bërë, nisur nga gjendja e rrugës që është tani, sepse unë lëviz dy herë në javë në atë aks dhe shikoj që edhe ajo që është bërë e re, që ka mbaruar vitin që shkoi, ka probleme të mëdha inxhinierike. Pra, a është bërë ndonjë herë një analizë e tillë në ARRSH, në mënyrë që të kuptojmë se kur kemi bërë prokurimin publik, kur kemi ndjekur procedurën, apo kur kemi shpallur një fitues për një kontratë të caktuar, ne kemi bërë zgjedhjen e duhur për përdorimin me eficiencë të parasë, por edhe për mbrojtjen e interesit publik në vetvete?

Lulzim Mata – Për hir të së vërtetës, kontratat në atë aks rrugorë nuk është se janë konsideruar anomalisht të ulëta, që t’i referohem pjesës së parë, pra, kontraktorët kanë fituar mbi bazën e një konkurrence jo shumë të ulët. Kjo, në çdo rast nuk e shfuqizon faktin se punimet duhet të ishin bërë në përputhje me specifikimet e projektit të miratuar dhe të hedhur për procedurë prokurimi. Në dijeninë time vonesa ka ardhur për mungesë financimi në atë aks rrugor dhe në shumë akse të tjera, gjë që ka çuar në dëmtimin më të madh të pjesës së rrugës. Por punimet, në çdo rast, në momentin e përfundimit dhe dorëzimit pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar do të kualidohen nga një komision i posaçëm. Nëse punimet nuk do të jenë në përputhje me specifikimet dhe me termat e referencës, së dhënë në dokumentet e tenderit si pjesë e kontratës, normalisht nuk do të merren me dorëzim dhe operatori ekonomik i bazuar në KPP do të shkojë për përjashtim, për mosrealizim kontrate në përputhje me kushtet e kërkuara.

Erion Braçe – A i keni çuar ndonjëherë në ARRSH?

Lulzim Mata – Për mosrealizim kontrate nuk ka ndodhur, ndërsa për dokumente të tjera ka ndodhur.

Erion Braçe – Zoti Mataj, ju dëgjuam me shumë vëmendje dhe pikërisht këtë vërejtje ju e kishit për Komisionin e Prokurimit Publik, tani dua t’ju pyes Autoriteti Rrugor Shqiptar në 28 vjet, më herët si Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe tani si Autoritet Rrugor Shqiptar, a i ka hequr licencën ndonjë kompanie, pikërisht për këtë gjë? Sepse nga ajo që ju shpjegoni unë kuptoj që problemi nuk është te prokurimi, por te realizimi i kontratës sipas specifikimeve teknike. Atëherë dua të di nëse Autoriteti Rrugor e ka bërë këtë gjë ndonjëherë.

Lulzim Mata – Nuk e kujtoj mirë vitin, në 2007-ën apo në 2008-ën ka qenë, por personalisht kam qenë në cilësinë e juristit kur kam firmosur, se atëherë nuk kishte sektor prokurimesh, dhe më pas janë dërguar për përjashtim rreth 8 operatorë ekonomikë shumë rëndësishëm. Ndërsa përpara disa viteve i është hequr licenca provizorish kompanisë “Geci”, për punime jo konform termave të referencave të dhëna.

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Po urdhëro zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Kisha dy pyetje. E para, numri i ankimimeve në KPP nga operatorët privatë për Autoritetin tuaj është rritur, apo është ulur dhe në sa raste vendimet e KPP-së kanë lënë në fuqi vendimin Komisionit të Prokurimit Publik?

E dyta, a ka përgjegjësi Autoriteti Rrugor Shqiptar për mospërfundimin e punimeve në *bypass*-et e Fierit dhe të Vlorës? Ju si kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik ku e shikoni këtë vështirësi ose çfarë problemi mendoni se ka penguar përfundimin e tyre dhe a ka ndonjë vendimarrje? A është lidhur kontrata? A do të vazhdojnë apo nuk do të vazhdojnë dhe kur do të jemi në gjendje të dimë apo të kemi një datë kur këto dy akse do të përfundojnë dhe do të merren në dorëzim nga ju?

Erion Braçe – Jo, nuk është zoti Mataj këtu për të thënë se kur përfundojnë punimet në ato akse. Thërrisni ministrin për të marrë shpjegime për këtë pjesë, se kur mbarojnë rrugët. Ministrin e keni edhe të partisë tuaj dhe mund ta zgjidhni fare kollaj këtë pyetje.

Zoti Mataj, për problematikën që lidhet...

Lulzim Mata – Lidhur me ankesat në Komisionin e Prokurimit Publik, rastet e vendimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar në KPP nuk janë të mëdha, për hir të së vërtetës, mund të numërojmë 2 ose 3 procedura, kryesisht për projektim ose supervizon, ndërsa për ndërtimet shumë më pak. Ka pasur disa raste, për shembull, vjet pati dy raste ku Komisioni i Prokurimit Publik ka kthyer vendimet e Komisionit Disiplinor të Vlerësimit të Ofertave në Autoritetin Rrugor Shqiptar, pavarësisht se me një vit vonesë, e thashë edhe më përpara që gati humbi sensi i vendimit. Pra, është minimizuar, por në një rast, kur unë kam qenë në komision, KPP-ja me vendimin e saj ka shkelur totalisht ligjin, duke dhënë një vendim të padrejtë, pavarësisht se është zbatuar nga ana jonë. Kjo është në gjykimin tim gjithmonë.

Erion Braçe – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ka ndodhur dhe shikojmë raste që vepra publike nisin dhe mbarojnë mbas 8 apo 9 vjetësh. Unë e kuptoj justifikimin me fondet publike dhe deri diku përgjegjësinë politike, e cila bën një rishplarje me zgjedhjet, por megjithatë përtej politikës dhe çfarë vendosin qytetarët kur votojnë, nuk ka Autoriteti Rrugor Shqiptar mënyra që të mos i tenderojë këto projekte a, kur i shikon që nuk janë të realizueshme nga ana inxhinierike, siç ka ndodhur, b, kur nuk financohen në kohë dhe bëhen shpeshherë për vendime politike fushatash dhe c, nuk ka për të pasur kapacitete ndoshta zbatueshmërie, firmash, mundësish siç po ndodh, në mënyrë që të mos kemi gangrena të tilla? Dakord, ju jeni në rregull me letrat, si do që të jetë, ne kalojmë përsëri në zgjedhje mbas 4 apo 8 vjetësh ndryshojmë përsëri dhe mbetet politike, por në fund e hanë fondet e shqiptarëve, taksapaguesve. Gjithë këto para që ngelen, nëse një projekt që ka nisur që në vitin 2009, si për shembull *bypass*-i i Fierit, vazhdon edhe sot që jemi në 2018 dhe nuk mbaron për 10 vjet, këto nuk janë argumente. Autoriteti, a do të ketë një ditë autoritetin që të ngrejë kokën që t'u thotë shtetit dhe partive politike që kjo punë nuk bëhet, sepse nuk i kemi paratë, nëse i kemi na i jepni që në fillim? Sepse edhe nga kjo histori që nuk kemi fondet dalin të gjithë të larë, ne themi që nuk ishte prioritet politik dhe ndryshoi, ju thoni ata nuk na dhanë fondet dhe në fund faji nuk i mbetet asnjërit, ndërkohë që në këto vepra ka aksidente rrugore, vdesin njerëz, pengohet zhvillimi ekonomik. Veprat, nëse nuk mbarohen në kohë, i merr lumi, uji dhe prishen, pastaj i rishtrojmë edhe një herë, në momentin që kualidohet një pjesë, sapo ka filluar pjesa

tjetër, pastaj lidhen bashkë e të tjera. Me ndërtimin jam marrë edhe unë të gjithë proceset i kthejnë dhe nuk mbarojnë ndonjëherë, duket si muret e Rozafës.

Lulzim Mata – Faleminderit!

Atëherë, çështja e prioritetit të ndërtimit të rrugëve nuk më përket mua, por është një proces që i përket një komisioni të posaçëm të Autoritetit Rrugor Shqiptar, kuptohet në përputhje me udhëzimet dhe me projektet e qeverisë. Problemi i vonesës kryesisht ka qenë financiar. Ne i fillojmë kontratat dhe të gjitha kalojnë vitin buxhetor. Për të hapur një proces prokurimi, bazuar në udhëzimin për buxhetin, duhet të kemi jo më pak se 20% të fondeve në dispozicion, gjë që e kemi respektuar gjithmonë. Gjithashtu marrim dhe një garanci nga ministri i linjës që këto fonde do të jenë të garantuara në vitet pasardhëse, por nëse fondet nuk janë të garantuara, nuk besoj se mbetet përgjegjësi jona. Por nuk ka pasur raste, ose mua nuk më kujtohet, që një projekt t'i ketë pasur të gjitha paratë dhe të mos jetë realizuar. Kuptohet që nëse zgjatet pafundësisht cilësia punimeve, pjesa e amortizimit e të tjera bien dhe kërkesa e llogarisë është pak më e ulët. Ka pasur raste që edhe operatorët kanë punuar me paratë e tyre. Por kjo besoj që është një vendimmarrje e rëndësishme...

Ervin Bushati – Të bëj edhe një pyetje, nuk e di se ku mund të ketë ndodhur, në ato vende që i shohim nëpër filma, që të ketë një mekanizëm ligjor që në momentin që nuk zbatohet kontrata dhe Ministria e Financave bllokoi fondet, ti të jesh i detyruar, që te njësia e prokurimit të dërgosh një letër që i shkon drejtorit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili duhet të dalë dhe të bëjë një deklaratë ku të thuhet: Ministria na ka bllokuar lekët. Pra të ndërtojmë një mekanizëm me disa zile alarmi që të bien në momentin që ne shohim që nuk ka një vullnet financiar politik, prioritar e të tjera. A ka ligje të tilla në botë dhe a mund të funksionojnë në Shqipëri? Ti që në momentin që e shikon që rruga e Plepave, e Rrogozhinës apo e *bypass*-it, sepse ti ke këtu që në vitin 2012, do të thotë 6 vjet...

Lulzim Mata – Që në vitin 2007 jam.

Ervin Bushati – Që në vitin 2007 merresh me rrugë, pra duhet ta quash veten pjesë të një ekipi dhe ti e di shumë mirë se si bëhen rrugët dhe nuk mund të thuash kështu, (edhe mund ta thuash, sepse ligjërisht je në rregull, por unë dua ta kuptoj vetë). Në momentin që lidhet kontrata, nëse që mbas 6 muajsh nuk është bërë 85% e punimeve dhe nëse nuk është garantuar 90% e punimeve për të vazhduar edhe 6 mujorin tjetër, të ndizet një sistem alarmi që të të vijë ty dhe deklarata t'i shkojë drejtorit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, pavarësisht se është vartësi i ministrit

dhe kryeministrit, të jetë i detyruar të lexojë një deklaratë ku tët huhet: “Kjo vepër publike cenohet të bëhet dhe nuk ka për t’u bërë në kohë, sepse 1,2,3 faktorë tregojnë që nuk ka për t’u bërë. Sepse ndryshe kjo do të vazhdojë historikisht. A ka ndonjë format në Danimarkë, Suedi, Islandë apo në ndonjë vend tjetër?

Lulzim Mata – Ju garantoj se në çdo rast është mungesa e financimit, madje operatorët tanë ekonomikë janë shumë liberalë në këtë punë, sepse asnjë nga operatorët nuk i ka pezulluar punimet dhe nuk ka thënë që i kam pezulluar punimet dhe nuk bëj asnjë punë deri në momentin që të më garantohet fondi. Duke qenë se miratimi i buxhetit është vjetor, nëse unë i kam parashikuar punimet në 2018-ën...

Ervin Bushati – Këtë e kuptoj, por a ka ndonjë ligj që të thuhet që në momentin që ti...

Lulzim Mata – Je i detyruar të garantosh pjesën e kontratës.

Ervin Bushati – A të ka ndodhur ndonjë herë që mbas 3 muajsh të shikosh që nuk po ecën mirë? Ti je te prokurimet dhe e mbaron detyrën tënde dhe po të duash ti nuk i flet fare atij që është te pjesa e zbatimit, a ka ndonjë sistem, nëse e kërkojmë ta bëjmë si ligj, në një vend të botës që në momentin që ti lidh kontratën të vazhdosh ta ndjekësh dhe e shikon që mbas 2 muajsh nuk ecën dhe ti t’i dërgosh letra drejtorit dhe drejtori të dalë mbas 6 muajsh dhe të thotë që kjo detyrë nuk zbatohet dhe nuk ka për t’u zbatuar?

Lulzim Mata – Nuk mendoj se kjo është çështje kambane apo alarmi, se sa është mungesë objektive e financimit, sepse në çdo rast kur ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ervin Bushati – Kështu mund t’i çosh një letër drejtorit dhe ti thuash: i dashur koleg, me sa po shikoj nga termat e kontratës dhe me çfarë ka ndodhur në 100 vjet infrastrukturë rrugore, kjo nuk do të zbatohet në kohë. E keni për detyrë ligjore, me filan ligj të njoftohet drejtori i Autoritetit Rrugor, i cili të njoftojë ministrin dhe të shkojë deri te Kryeministri dhe të thuhet që të mos bëhet më politike

Erion Braçe – Është jashtë fushës së zotërisë, kjo gjë. Por të gjitha këto duhen pasur parasysh kur prokurohen, sepse atje fillon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka pyetje te tjera?

Zoti Mata, faleminderit për prezencën tuaj, për prezantimin dhe për përgjigjet që na dhatë!

Faleminderit!

Mbledhje mbyllet këtu, fillon nesër në orën 9:00.

MBYLLET MBLEDHJA